This project is funded by the European Union

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Hedayah
countering violent extremism

UDHËZUES
PËR
MËSUESIT E LETËRSISË
SË SHKOLLAVE TË MESME

AKTIVITETE EDUKATIVE PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

2020

UDHËZUES

PËR MËSUESIT E LETËRSISË SË SHKOLLAVE TË MESME

MBI

Aktivitete edukative të bazuara në vlera, për të parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm tek të rinjtë në Shqipëri

Hartuan

Prof. Dr. Dhurata Shehri

Dr. Edlira Macaj

Ky udhëzues u hartua në kuadër të projektit "Aktivitete edukative të bazuara në vlera, për të parandaluar Ekstremizmin e Dhunshëm tek të rinjtë në Shqipëri", financuar nga Hedayah dhe Bashkimi Evropian. Opinionet dhe rekomandimet e shprehura këtu, janë të ekspertëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Hedayah, Bashkimit Europian apo Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

2020

Përmbajtja

LISTA E SHKURTIMEVE 4

TERMA SHPJEGUES 5

HYRJE 6

OBJEKTIVAT E UDHËZUESIT 8

FUNKSIONI PRAKTIK I UDHËZUESIT 8

SHQYRTIMI I LITERATURËS 10

1. Arsimi në shkollat e mesme me qendërsim të mësuarit përmes kompetencave 10

2. Letërsia si mundësi për promovimin e vlerave themelore në edukimin e të rinjve dhe parandalimin e esktremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit 13

PJESËMARRËSIT DHE BASHKËPUNIMI MES TYRE 17

1. Bashkëpunimi shkollë/familje (mësues-psikolog/ -nxënës-prind) 17

2. Bashkëpunimi shkollë/familje/komunitet 18

TIPOLOGJIA DHE SHPËRNDARJA E AKTIVITETEVE (faza përgatitore) 20

MODALITETET E ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE 21

ROLI I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETET EDUKUESE 22

- **Mësuesit** 22
- **Nxënësit** 23
- **Prindërit** 24
- **Psikologët** 24
- **Përfaqësuesit fetarë** 25

AKTIVITETET DHE MEDIUMET (teknikalitete) 25

NDËRTIMI I SKEDËS DHE KALENDARI I VEPRIMTARIVE 29

METODOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARIVE 29

VEPRIMTARI I 29

Klubi i leximit; Klubi i debatit; Mediumi elektronik (risia: diskutim në chat) 29

***Çunat nuk qajnë*, Malorie Blackman** 29

VEPRIMTARI II 32

Klubi i debatit 32

***Unë jam Malala,* Malala Yousafzai** 32

VEPRIMTARI III 35

Klubi i debatit; klubi i leximit 35

***Babeli*, Jan De Leeuw** 35

VEPRIMTARI IV 37
Konkursi i eseve 37
***E bardha dhe e zeza*, Malorie Backman** 37
VEPRIMTARI V 39
Klubi i leximit; Klubi i filmit; Laboratori i informatikës; Biblioteka e shkollës 39
***Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Ismail Kadare** 39
VEPRIMTARIA VI 41
Klubi i debatit, Klubi artistik 41
***Kronikë në gur*, Ismail Kadare** 41
VEPRIMTARI VII 44
Klubi i dramës, klubi i filmit, klubi i debatit, Klubi artistik dhe TIK, konkursi i eseve 44
***Tre sprova mbi letërsinë botërore: Eskil, Dante, Shakespeare*, Ismail Kadare** 44
VEPRIMTARI VIII 47
Klubi i artit; Klubi i leximit 47
***Princi i vogël,* Antoine de Saint-Exupéry** 47
VEPRIMTARI IX 50
Klubi i leximit, Klubi i filmit, Klubi i debatit, Klubi krijues 50
Udhëtim në kërkim të vetvetes 50
1. ***Gjuetari i balonave*, Khaled Hossein** 50
2. ***Pa zemër në kraharor*, Mira Meksi** 50
3. ***Fundamentalist pa dashje*, Mohsin Hamid** 50
4. ***Alkimisti*, Paolo Coelho** 50
VEPRIMTARI X 54
Klubi i leximit, Klubi i filmit, Klubi i debatit, Klubi krijues, Klubi i dramës 54
Shfaqje përmbyllëse 54
MONITORIMI 56
PËRFUNDIME 58
REFERENCA 59

LISTA E SHKURTIMEVE

BE- Bashkimi Europian

DASH- Departamenti Amerikan i Shtetit

IDM- Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

IZHA- Instituti për Zhvillimin e Arsimit

MASR-Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë

VE- Ekstremizmi i Dhunshëm

TERMA SHPJEGUES

***Aktivitete edukative*:** aktivitetet edukuese ose udhëzuese nënkuptojnë aktivitetet që zhvillimin e tyre e sigurojnë përmes një strukture dinamike (mësues, staf) që lehtëson një mjedis mësimi, dhe një metodë udhëzimi prej të cilave organizohet komunikimi dhe përçohen dijet (te nxënësit) ose aftësitë e të nxënit. Ato janë të ndryshme në varësi të kategorive dhe qëllimit edukativ.
Këtu ato mbajnë kuptimin e aktivitetit mësimor të planifikuar në një model të caktuar me qëllime të qarta udhëzuese. Pra aktivitet mësimore kanë një qëllim dhe organizim në vetvete.[1] Mediumi i zhvillimit mund të jetë në platforma të ndryshme direkte ose indirekte (digjital, filmik) përmes teknologjive të ndryshme të komunikimit, etj.

Narrativë[2]: është një histori ose një përshkrim i një serie ngjarjesh apo situatash të cilat reflektojnë qëndrime apo sjellje të caktuara. Në këtë kurrikulë trajnimi, termi narrativë përdoret për të treguar qëndrimet apo ngjarjet që ndodhin në kontekst të radikalizimit apo ekstremizmit të dhunshëm.

Radikalizimi në dhunë, një vendim për të anashkaluar proceset politike apo metodat jo të dhunshme të nxitjes së ndryshimit, duke favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme për të sjellë ndryshimin.

Ekstremizëm i dhunshëm, përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politikë.

Kundëradikalizimi, një paketë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t'i frenuar individët e pakënaqur (dhe, me gjasë, tashmë të radikalizuar) që t'i drejtohen terrorizmit.

Qëndresë, faktorët, idetë, institucionet, çështjet, prirjet ose vlerat që iu japin mundësi individëve dhe komuniteteve t'i bëjnë qëndresë dhunës ose ta parandalojnë atë.

Luftëtarë të huaj terroristë, individë të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen apo pjesëmarrjen në akte terroriste ose ofrimin a përftimin e trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur

[1] Classification of learning activities (CLA) MANUAL. Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2016, f. 10
[2] Ky koncept dhe të tjerët më poshtë janë referuar sipas:
https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/strategjia_kombetare_per_luften_kunder_ekstrmizmit.pdf

HYRJE

Edukimi i të rinjve në çdo vend është i rëndësishëm dhe duhet të jetë prioritet i politikave kombëtare për shkak të sfidave që ka edhe vetë procesi edukues në një shoqëri që përjeton ndryshime të shpejta dhe, si rrjedhojë, përballet edhe me probleme të reja. Roli i arsimit në formimin e brezave të rinj të shoqërisë, përveç procesit të të nxënit, konsideron edhe çështje të tjera të cilat duhet të jenë edhe fokusi i vetë procesit edukues.

Projekti "Aktivitete edukative të bazuara në vlera, për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm midis të rinjve në Shqipëri", me mbështetjen e Hedayah, financuar nga Bashkimi Evropian, synon të promovojë edukimin e të rinjve me vlera thelbësore për një shoqëri demokratike siç janë: toleranca, mirëkuptimi, paqja, gjithëpërfshirja dhe respekti i ndërsjellë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (VE) në Shqipëri, bazuar te letërsia.

Një ndër nismat e tij është edhe hartimi i një udhëzuesi për mësuesit e shkollave të mesme duke i konsideruar ato si qendër komunitare. Ky udhëzues do t'i ndihmojë ata në punën e tyre për të ndërtuar aktivitete edukuese me anë të qasjeve të reja ndaj veprave letrare dhe përfshirjes së natyrshme në to edhe të aktorëve të tjerë, në dukje periferikë, por në përmbajtje shumë të rëndësishëm në procesin edukues të të rinjve (prindër, psikologë, përfaqësues fetarë si pjesë e komunitetit, etj.)

Ky udhëzues drejtuar mësuesve është konceptuar në dy pjesë kryesore: pjesa e parë me qëllime didaktike dhe përshkrimore (mbi procesin, kompetencat, pozicionimet e partnerëve, rëndësinë, rregullat etj.) dhe pjesa e dytë konkrete (mbi modalitetet e zhvillimit të veprimtarive)

Pjesa e parë merret me zbërthimin e qëllimeve didaktike sipas rolit të të gjithë aktorëve të përfshirë. Pas shqyrtimit të literaturës mbi funksionimin e edukimit në shkollat e mesme në Shqipëri në kuadër të legjislacionit, mungesës së materialeve udhëzuese rreth objektivit tonë, rëndësisë dhe profesionalizmit të mësuesve etj., ai do të shtjellojë rëndësinë e edukimit, dhe veçanërisht rolin e mësuesve për promovimin e vlerave estetike të veprave letrare, si edhe të orientimit të nxënësve drejt vlerave qytetare themelore, pasi në të ardhmen e shpejtë, ata do të jenë anëtarë të komunitetit. Udhëzuesi në këtë pjesë të parë teorike do të shpjegojë edhe pozicionet që do të ketë secili aktor në këtë proces edukimi.

Pjesa ndërmjetëse që paraprin veprimtaritë konkrete do të shpjegojë mënyrën sesi do të funksionojnë veprimtaritë, si do të grupohen dhe organizohen duke paraqitur shkurtimisht një skedë përmbledhëse prezantimi info-kalendarike rreth titujve, zbatuesve dhe periudhës kohore kur ato do të zhvillohen.

Pjesa e dytë e udhëzuesit të mësuesit do t'i shpjegojë atyre në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hollësishme sa aktivitete do të realizohen dhe si do të realizohen atoduke u mbështetur në propozimin e e 12 titujve të rinj që do të jenë në qendër të aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë gjithë vitit shkollor.

Ky udhëzues i pari në llojin e tij, në përmbajtje do të ketë:

- ✓ **Informacione për rëndësinë e ndërgjegjësimit** të të rinjve rreth parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizimit
- ✓ **Një strategji bashkëpunimi** mes disa faktorëve dinamikë që marrin pjesë drejtpërsëdrejti në procesin e edukimit: mësues, nxënës, prind, psikolog, drejtues fetar etj;
- ✓ **Një vizion** të qartë edukues në qendër të të cilit është vetë nxënësi përmes kompetencave dhe mësuesi si drejtues dhe bashkëpunues me ta;
- ✓ **Synimin për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimin** duke edukuar me efikasitet përmes magjisë transformuese gjeneruese të letërsisë dhe vlerave që burojnë prej saj;
- ✓ **Inkurajimin e të rinjve për të promovuar vlerat themelore** qytetare të demokracisë.

Ky udhëzues në pjesën praktike të tij do të sugjerojë realizimin e 10 veprimtarive të mëdha të cilat mund të zhvillohen në disa orë/ditë duke përfshirë disa modele:

- ✓ **Praktika të drejtpërdrejta gjithëpërfshirëse** të vetë nxënësve;
- ✓ **Rritjen e funksionalitetit të Klubeve të Leximit** përmes leximeve konkrete nga pjesët e veprave të sugjeruara;
- ✓ **Sugjerime për dramatizime, desktop-theater[3], lojë me role** të pjesëve të ndryshme letrare;
- ✓ **Konkurse debati tematike** bazuar në temat dhe motivet e veprave letrare;
- ✓ **Konkurse esesh tematike** për promovimin e vlerave dhe të menduarit kritik e krijues;
- ✓ **Ditë të hapura (Open days)** kushtuar kulturave, apo vendeve me rëndësi të veçantë etj.
- ✓ **Propozime ekskursionesh (turesh) letrare me qëllime didaktike** për promovimin e vlerave qytetare dhe identitare;
- ✓ **Aktivizimin e Klubit Artistik dhe Teknologjik** për promovimin e projekteve artistike nëpërmjet aplikacioneve apo platformave digjitale etj.

[3] **Desktop Theater** është një projekt performance që konsiston në një seri eksperimentesh teatrore të ndërtuara në rrjet duke përdorur dhomat e diskutimit dhe chat-in virtual. Ky projekt ka për qëllim të përfshijë publikun si ndërveprues me teatrin on line.

OBJEKTIVAT E UDHËZUESIT

Udhëzuesi për mësuesit e shkollave të mesme i konceptuar si një aparat didaktik hartohet për të qenë praktik për punën e tyre të përditshme duke marrë përsipër:

- ✓ **Orientimin** e mësuesve të shkollave të mesme drejt metodave të reja të mësimdhënies së orëve të letërsisë, duke shfrytëzuar formate të ndryshme me qëllim për t'i bërë orët e letërsisë interaktive, të efektshme dhe edukuese;
- ✓ **Edukimin e nxënësve me rezultate praktike dhe konkrete** përsa i përket përvetësimit të vlerave universale, atyre qytetare si: respektimi reciprok, bashkëpunimi, paqja, mbrojtja, gjithëpërfshirja, toleranca, etj. , vlera të cilat perceptohen përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitetet letrare të natyrave të ndryshme;
- ✓ **Ndërgjegjësimin** e nxënësve përmes kuptimit të veprave letrare për të parandaluar ekstremizmin në tërësi dhe në mënyrë të veçantë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, dukuri të pranishme tashmë në të gjithë shoqëritë e sotme, të ndjeshme dhe delikate për t'u trajtuar te nxënësit e shkollave të mesme;
- ✓ Ky udhëzues **ndihmon dhe mbështet** rolin që luajnë mësuesit në procesin edukues të të rinjve për parandalimin e të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, në krijimin dhe nxitjen e bashkëveprimit mes mësuesve dhe nxënësve, shkollës dhe familjes, familjes dhe profesionistëve, psikologëve, shkollës, familjes si edhe fesë si një ndërmjetëse për promovimin e vlerave qytetare;
- ✓ Udhëzuesi u adresohet mësuesve në veçanti **për të zbatuar aktivitete të ndryshme** me metoda dhe mënyra të reja bashkëkohore dhe tërheqëse për të rinjtë, bazuar te 12 vepra letrare të cilat promovojnë vlerat thelbësore qytetare. Aktivitetet zhvillohen me një strukturë të përcaktuar mbi qëllimin, pjesëmarrësin, objektin konkret, përfitimet nga lloji i aktivitetit, vendin, mënyrën e zbatimit, kohën etj;
- ✓ Udhëzuesi **paraqet modele konkrete veprimtarish** edukative për 12 titujt e sugjeruar;

FUNKSIONI PRAKTIK I UDHËZUESIT

Në kontekstin e ndryshimeve sociale, por edhe edhe në arsim nëpërmjet situatave të ndryshme, shihet e nevojshme të propozohet ky udhëzues i veçantë i vlefshëm për mësuesit të cilët do të lidhin drejtpërsëdrejti procesin e edukimit nëpërmjet promovimit të vlerave thelbësore qytetare e demokratike, duke aktivizuar fuqinë dhe përshtashmërinë për çdo kontekst të një lënde specifike, siç letërsia është.

Natyra e udhëzuesve që janë botuar deri më tani për shkollat e mesme, nuk lidhet me procesin integrues të një lënde specifike, me vlerat qytetare siç përpiqet të propozojë ky udhëzues, objektin e të cilit do e qartësojmë më poshtë. Kjo pasi, asnjë syresh nuk i kushtohet lidhjes së drejtpërdrejtë të një lënde siç është letërsia e cila përmban në vetvete një mundësi të madhe për të edukuar të rinjtë edhe përtej objektivave të saj kurrikulare, falë aftësisë së saj të madhe gjeneruese të ideve prej nga do propozohen një seri aktivitetesh edukuese në qendër të të

cilave do të jetë vetë nxënësi. Ka përpjekje botimesh për ndërhyrjet pozitive lidhur me sjelljet në shkollë[4], por kjo përpjekje nuk është e shtrirë në udhëzime apo modele specifikisht për shkollat e mesme dhe as e propozuar në lidhje me një lëndë specifike siç letërsia është.

Ky udhëzues në mënyrë të veçantë shërben për të prezantuar aktivitetet edukative në funksion të parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit (Nëntor 2015), mes të tjerave thekson nevojën për ta përqendruar punën për parandalimin e ekstremizmit në edukimit përmes programeve të trajnimit.[5] Procesi edukues i të rinjve duhet të mbështetet herë pas here me udhëzime të nevojshme, siç e kanë të nevojshme të gjitha hallkat e procesit.

Në këtë udhëzues do të fitojnë rolin e tyre përkatës, sipas rëndësisë, të gjithë aktivitetet e propozuara për të përmbushur qëllimin e mësipërm pasi të merren në konsideratë të gjithë aktorët pjesëmarrës të ekzekutimit zinxhir të kësaj skeme edukative. Pra, përveç mësuesve, zbatues të aktiviteteve, aktorë dhe përfitues janë nxënësit. Mbështetës dhe këshillues janë prindërit dhe psikologët, por edhe përfaqësuesit fetarë si pjesë e komunitetit dhe mbështetës të vlerave universale. Kjo zgjedhje integrimi shumëpalëshe vlerësohet në metodikat zbatuese të aktiviteteve, për të përcaktuar rolin e secilit partner në procesin edukativ të të rinjve. Ajo shërbenedhe për të ideuar një raport të bashkëpunimit reciprok si edhe kalendarin e aktiviteteve të cilat do të jenë të ndara me tematika të veçanta sipas temave që do të trajtojnë dhe modeleve që do të përfaqësojnë në formate të larmishme. Në to, vetë nxënësit do të përfshihen dhe të bëhen protagonistë vetë nxënësit, por dotë ndihmojnë në zbërthimin dhe promovimin e vlerave edhe aktorë të tjerë brenda dhe jashtë shkollës si prindërit, psikologët apo përfaqësuesit fetarë, do të jetë propozimi bosht i këtij udhëzimi.

Të gjitha aktivitetet edukuese të zhvilluara me modele të reja dhe konkrete do të kenë një organizim specifik në varësi të tematikës, pjesëmarrësve, kompetencave të nxënësve, kontributit të aktorëve të tjerë, në mënyrë që aktiviteti të mos angazhojë vetëm njërën palë, por të shihet si një sinergji mes të githë palëve të interesit për të përftuar një rezultat më të plotë në lidhje me vlerat estetike, fenë dhe ekstremizmin. Vetëm duke u trajtuar si një sinergji mes partnerësh bashkëveprues procesi i edukimit do të synojë cilësinë dhe do të arrijë efektshmërinë mes këtyre propozimeve të reja dhe konkrete.

Të gjitha aktivitetet e planifikuara për t'u zbatuar nga mësuesit përmes formateve të paelaboruara më parë do të shpjegohen metodologjikisht në këtë manual dhe të gjitha ato do të jenë produkt specifikisht i 12 titujve të rinj të cilët do të zbërthehen, analizohen, interpretohen, performohen, rikrijohen, etj., në varësi të llojit të aktivitetit përkatës.

Veprimtaritë do të jenë të organizuara sipas llojit, tipareve dhe veçorive promovuese, mënyrës së zbatimit në disa grupime tipologjike. Këto aktivitete do të udhëhiqen nga mësuesit dhe zbatohen nga nxënësit, pasi të kenë në fokusin e tyre edukimin drejt vlerave themelore përmes ushtrimit të të gjithë **kompetencave** të nxënësve, nisur nga *tetë kompetencat themelore*

[4] "Ndërhyrjet për sjelljet pozitive në shkollë si mënyrë për parandalimin e dhunës", udhëzues për shkollat nëntëvjeçare https://www.ascap.edu.al/nderhyrjet-per-sjelljet-pozitive-ne-shkolle/
[5] "Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit" (Nëntor 2015)

europiane[6] *(komunikimi në gjuhën amtare, të huaj, kompetencat në shkenca dhe tekonologji, kompetencat digjitale, të të nxënit gjatëgjithë jetës, ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare, sipërmarrjen të identitetit, mirëkuptimit, ideve etj.)*

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Sot edukimi i të rinjve është sfidë e vështirë kur përballet me probleme si ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi apo intolerancat që ekzistojnë në shoqëri apo edhe tek vetë komuniteti i të rinjve, për shkak të **gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale apo për motive dhe shkaqe të tjera.** Ndaj është vlerësuar në të gjithë shoqëritë roli i rëndësishëm i edukimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që në nismën e parë siç ishte plani i veprimit për parandalimin e tyre, plan që sheh si kundërpërgjigje **rëndësinë e edukimit cilësor**.[7]

Në këtë kontekst është shumë i rëndësishëm përqendrimi në situatën pas zbatimit të aktiviteteve kyçe të projektit, pra vlerësimi i ndikimit të tyre. Sa mund ta përmirësojnë situatën këto lloj aktivitetesh? Vlerësimi i impaktit real kërkon një periudhë më afagjatë, megjithatë, sa më shpejt të fillohet edukimi te të rinjtë për rreziqet që paraqet ekstremizmi, aq më efektiv është ai. Një mënyrë për t'iu qasur nxënësve të shkollave të mesme me efektivitet për objektivat që mësuesit kanë është që ata, para se të zhvillohen aktivitetet, të kenë një model reference, pra të jenë hartuar politika konkrete dhe strategji edukuese që sugjerojnë dhe mbështesin gjithëpërfshirjen në këto aktivitete që mund të planifikohen rregullisht gjatë vitit shkollor. Në këtë drejtim, është i nevojshëm, ndonëse impenjativ, një bashkëpunim i ngushtë me mësuesit, psikologët, prindërit dhe drejtuesit fetarë si pjesë e komunitetit, bashkëpunim i cili duhet të konkretizohet me zbatimin tematik të veprimtarive me qëllim dhe objekt, jo vetëm të mësuarit përmes kompetencave, por edhe ndërgjegjësimin e të rinjve ndaj rreziqeve që sjellin sjelljet intolerante, mosrespektimi i kulturës së 'tjetrit' etj.

1. Arsimi në shkollat e mesme me qendërsim të mësuarit përmes kompetencave

Të përdorësh letërsinë, e cila në vetvete është art i fjalës, për të edukuar brezat e rinj drejt vlerave thelbësore qytetare për të parandaluar ekstremizmin dhe radikalizimin, kërkon një parashtrim të lidhjes së të gjithë koncepteve që do të përfshihen në të. Kjo për të qartësuar lidhjet, bashkëveprimet mes tyre dhe të orientojë shqyrtimin teorik drejt mbështetjes për rezultatet konkrete të veprimtarive të grupuara, sipas disa kritereve metodike. Në këtë kontekst, duhet marrë në konsideratë kuadri i plotë i edukimit në shkollat e mesme në Shqipëri, mënyrat udhëzuese për përmirësimin e procesit dhe vetë nxënësin dhe të mësuarit e tij me kompetenca. Shqyrtimi i këtij kuadri dhe prezantimi i rezultateve të tij në lidhje me përballimin e problemit të

[6] "Key Competences-Curriculum Reform, Synthesis, Report, on Peer Learning Activities." Belgium.: EU Commission. EU, 2017

[7] *A Teacher's guide on the prevention of violent extremism*, UNESCO, 2016

mungesës së vlerave qytetare dhe ekstremizmin, të cilat janë në forma të ndryshme shfaqjeje në shoqëri, do të ndihmojë në ndërtimin e aktiviteteve të ndërmarra për këtë qëllim.

Arsimi parauniversitar, në Shqipëri, pjesë e të cilit është edhe ai i shkollës së mesme është i rregulluar me ligj[8], por ndryshimet në procesin arsimor vijnë përmes politikave aktive dhe vizioneve të cilat kanë nevojë të rishikohen dhe të përditësohen në varësi të kontekstit dhe situatës sociale dhe ekonomike. E tillë ishte strategjia e zhvillimit e propozuar në projekt-draftin e strategjive 2014-2020, që sheh si qëllim dhe vizion në vetvete nxënësin. Sistemi arsimor që ka në qendër nxënësin, mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe i shërben konsolidimit të shoqërisë demokratike.Ndër objektivat politikë të parashikuar në këtë strategji janë edhe reformimi i kurikulave, gjithëpërfshirja, shkolla si qendër komunitare, digjitalizimi i procesit të të nxënit etj.[9]

Qendërsimi i nxënësit në proces sjell me vete edhe sfida të reja për t'u përballur në procesin e edukimit. Ndaj, edukimi i të rinjve në shkollat e mesme (të përgjithshme ose jo) merr një rëndësi të veçantë edhe për shkak të kujdesit që duhet treguar me moshën e kësaj kategorie nxënësish.

Institucionet përkatëse IZHA, MASR, bëjnë përpjekje të vijueshme për të ndihmuar edukimin me anë të botimeve udhëzuese. Udhëzuesit e shkollave të mesme drejtuar mësuesve, nxënësve, prindërve, etj. qëmtojnë dhe përpiqen të zgjidhin problemet dhe të japin sugjerime lidhur me kurikulat, edukimin mbi emergjencat dhe sigurinë, situatat e të nxënit etj[10]. Por edhe në organizimet e kurikulave tona shkollore, është parashikuar edukimi përmes kompetencave, i cili është një metodologji qendrore e programeve e qartësuar nëpërmjet botimeve të herëpashershme të institucioneve përkatëse si IZHA[11], dhe MASR[12]. Të gjitha aktivitetet edukative mbështeten dhe fuqizojnë të mësuarit përmes kompetencave të shprehura në nenin 13, të ligjit të përditësuar të arsimit parauniversitar [13] si më poshtë: "Neni 13/ Kompetencat themelore për të gjithë nxënësit janë: a) kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; b) kompetenca e të menduarit; c) kompetenca e të mësuarit për të nxënë; ç) kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin; d)kompetenca personale; dh) kompetenca qytetare; e)kompetenca digjitale."

Këshilli i Bashkimit Europian ka përshtatur rekomandimet mbi kompetencat kyçe të të mësuarit në 22 maj 2018, duke orientuar të mësuarit me tetë kompetencat bazë, të cilat bëhen thelbësore për mënyrat e edukimit dhe trajnimit të partnerëve në procesin edukues. Kjo referencë bëhet për

[8] Ligji 69/2012, RSH, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë." Tiranë: Fletorja Zyrtare e Ligjeve të RSH, 2012. Ndryshuar me ligjin nr.56/2015,datë 28.5.2015

[9] "Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020," (Draft), MAS, 2014, f. 32;42, aksesuar në: https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Strategji_APU_dokumenti_perfundimtar_24_03_2015.pdf

[10] Udhëzues i aksesuar në: https://www.ascap.edu.al/category/udhezues/page/3/

[11] "Kurrikula e Arsimit parauniversitar e Republikës së Shqipërisë". Tiranë: IZHA, 2014

[12] "Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë." Tiranë: MAS, 2014.

[13] Ligji 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë". Tiranë.: Fletorja Zyrtare e Ligjeve, ndryshuar me ligjin nr.56/2015,datë 28.5.2015 : Për disa ndryshime në ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

të promovuar zhvillimin e këtyre kompetencave përmes qasjeve inovative të të mësuarit, metodave vlerësuese apo mbështetjes ndaj stafit edukues.[14]

Të gjithë aktivitetet e propozuara në këtë udhëzues kanë marrë në shqyrtim kompetencat e nxënësve dhe të gjitha janë konceptuar me qëllim zhvillimin e:

Kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit[15]. Në aktivitetet lidhur me këtë kompetencë, nxënësi shpreh mendimet e tij me anë të komunikimit verbal, (fjalë dhe shprehje artistike) dhe me anë të komunikimit joverbal (shenja, kode, simbole etj.), por edhe në formë elektronike duke përdorur teknologjitë e informacionit, e cila po gjen përdorim përherë e më të lartë nga të rinjtë. Gjatë kohës që nxënësi/ja komunikon me të tjerët, ai/ajo shfaqin edukatën e empatisë (duke vendosur veten në situatën e tjetrit) dhe të tolerancës reciproke. Nxënësi/ja komunikon dhe shprehet në mënyrë sa më konstruktive, demokratike e qytetare.

Kompetencës së të menduarit. Në aktivitetet e kësaj natyre nxënësi formon dhe më pas, mbron qëndrimet e tij në mënyrë të pavarur duke e analizuar, sintetizuar, gjykuar, vlerësuar dhe duke e interpretuar veprën letrare, përmes këtij mendimi. Me anë të këtij mendimi nxënësi vlerëson të tjerët dhe vetëvlerësohet. Ai kombinon e përshtat njohuritë e fituara në jetën e përditshme personale dhe komunitare.

Kompetencës së të mësuarit për të nxënë. Në aktivitetet promovuese të kësaj kompetence u jepet mundësia nxënësve të flasin në lidhje me tema nga përditshmëria, si dhe të realizojnë detyra apo aktivitete që u kërkohen në klasë.

Kompetencave për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. Ndër të tjera kjo kompetencë u jep mundësinë nxënësve të shprehin mendimet e tyre në lidhje me sjelljen e nxënësve në klasë apo edhe në mjediset jashtë klasës. Në njëfarë mënyrë ajo i përgatit nxënësit për të ardhmen.

Kompetencës personale, në të cilën nxënësit u përmbahen kodeve të sjelljes, duke shmangur në këtë mënyrë paragjykimet për kulturën, vlerat, traditat dhe besimet e të tjerëve, por duke i respektuar dhe pranuar ato. Kompetenca personale është e rëndësishme, pasi ajo i ndihmon nxënësit të menaxhojnë emocionet e tyre, t'ia njohin vetes përparësitë dhe dobësitë dhe të punojnë për kapërcimin e këtyre të fundit. Së fundmi, kompetenca personale, nxit frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis nxënësve.

Kompetencës qytetare. Kjo kompetencë zhvillon tek ata aftësinë e të vlerësuarit, diversitetin (të qënurit i ndryshëm) dhe aftësinë për të treguar tolerancë ndaj këtyre dallimeve. Nxënësit gjithashtu bëhen pjesëmarrës në proceset demokratike në të gjitha nivelet, si dhe bëhen të dobishëm duke kontribuar në zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve në nivel shkolle dhe komuniteti.

---

[14] European Comission. *Key competencies for lifelong learning.* Louxembourg, 2019 , aksesuar në: https://op.europa.eu/fr/publication-detail/-/publication/297a33c8-a1f3-11e9-9d01-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-107520914

[15]Përkufizimi i komptencave sipas: http://www.portalishkollor.al/kuriozitet/mesimdhenia-me-baze-kompetence, Punuan: Aurela Gjoka, Elton Gjurra, Indrit Çëkrezi dhe Vanxheli Janku

Kompetencës digjitale Kjo kompetencë mbështetet tek aftësitë themelore për të gjetur, krijuar, për të shkëmbyer informacion, për të komunikuar, si dhe për të bashkëpunuar, duke përdorur teknologjinë e informacionit si p.sh me rrjetet sociale, me apolikacionet e ndryshme që mund të krijojnë në internet etj.

Këto kompetenca të nxënësve në këtë udhëzues do të zhvillohen dhe thellohen përmes zbatimit të veprimtarive të letërsisë, të lidhura ngushtësisht me 12 titujt e rinj në të cilat gjejnë vend diskutime të vlefshme për të promovuar vlerat edukuese qytetare.

1. *Tri sprova mbi letërsinë botërore: Eskil, Dante, Shakespeare*, Ismail Kadare
2. *Kronikë në gur*, Ismail Kadare
3. *Gjenerali i Ushtrisë së vdekur*, Ismail Kadare
4. *Princi i Vogël*, Antoine de Saint Exupery
5. *E bardha dhe e zeza*, Malorie Blackman
6. *Çunat nuk qajnë*, Malorie Blackman
7. *Babeli*, Jan De Leeuë
8. *Gjuetari i balonave*, Khaled Hosseini
9. *Alkimisti*, Paolo Coelho
10. *Unë jam Malala*, Malala Yousafzai
11. *Fundamentalist padashje*, Mohsin Hamid
12. *Pa zemër në kraharor*, Mira Meksi

2. Letërsia si mundësi për promovimin e vlerave themelore në edukimin e të rinjve dhe parandalimin e esktremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

Nxënia përmes kompetencave i përgatit të rinjtë për të qenë të aftë të menaxhojnë situatat edhe në jetën e përditshme. Edukimi në sistemin parauniversitar, aq sa duhet të stimulojë nxënien e shkencave të ndryshme, aq edhe duhet ta ketë fokusin tek edukimi i të rinjve me vlera shoqërore e demokratike, pasi në shoqëri të ndryshme shfaqen probleme të karaktereve të ndryshme lidhur me grupime të caktuara shoqërore, sjellje apo transformime dhe devijime nga modelet e mira sociale. Rrezik në të gjitha shoqëritë është ndër të tjera ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi. Sa më e shpejtë të jetë ndërhyrja edukuese te brezat e rinj aq më i vogël bëhet ky rrezik në shoqëri. Në vendimin 46 të Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s[16], afirmohet njëzëri **rëndësia e arsimit** si një mjet për parandalimin e shumë shfaqjeve ekstremiste, ndër të tjera edhe

[16] Decision 46 adopted at the 197th session of UNESCO's Executive Board (197 EX/Decision 46) http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002351/235180e.pdf

intolerancës fetare, duke e parë shkollimin si angazhim social. Ka një unifikim në politikat ndërkombëtare për hartimin e strategjive dhe planeve konkrete për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që mund të çojnë drejt terrorizmit. Iniciativat e suksesshme të P/CVERLT bazohen në **qasjen e integruar të shoqërisë**, e cila shfrytëzon ndikimin dhe përpjekjet e shoqërisë civile, në veçanti të grave, të rinjve, mësuesve, udhëheqësve fetarë, dhe përfaqësuesve të komuniteteve.

Shpesh, janë realizuar me sukses studime dhe raporte lidhur me rrezikun e shtuar të këtij fenomeni në shoqëri, apo grupe të caktuara. Kështu, raporti i BE-së në vitin 2010 bëri vlerësimin e shkallës së rreziqeve të rritjes së intolerancës dhe diskriminimit ku përfshiheshin tetë rreziqe: *mungesa në rritje e tolerancës; mbështetja në rritje për partitë ksenofobike dhe populiste; diskriminimi; prania e një popullsie pothuajse pa të drejta; shoqëritë paralele; ekstremizmi islamik; humbja e lirive demokratike dhe një përplasje e mundshme ndërmjet "lirisë fetare" dhe lirisë së shprehjes*. Ky raport hartuar nga një numër ekspertësh, që e bazuan qasjen e tyre në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sidomos në liritë individuale dhe barazinë para ligjit, vuri në dukje se diskriminimi dhe mungesa e tolerancës sot janë një dukuri e përhapur në Evropë, sidomos në grupe të margjinalizuara[17] dhe rekomandon që shoqëritë duhet të pranojnë diversitetin duke respektuar 17 parimet orientuese mes të cilave njëra syresh është për barazinë: *barazi të vertetë mundësish*. Kjo përpjekje është e nevojshme për të siguruar që pjesëtarët e grupeve të ndryshme fetare, kulturore apo etnike të njihen me njëri tjetrin dhe të punojnë së bashku në grupime vullnetare, pra që politikat e vendeve të kenë strategji të përbashkët veprimi në fushën e diversitetit dhe të drejtave të njeriut".

Edhe Shqipëria ka treguar angazhim në përballjen me probleme në fushën e të drejtave të njeriut dhe diversitetit apo fenomene të tilla si VE. Lidhur me këtë të fundit ajo ka nënshkruar dhe ratifikuar të gjithë konventat dhe protokollet anti-terroriste të kombeve të bashkuara. Situata lidhur me fenomene të tilla si edhe me perceptimin e fesë, është pasqyruar edhe nga raporte të organizmave të huaja që e shtrijnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Raporte ndërkombëtare mbi çështje të besimeve fetare në Shqipëri, hetojnë ndër të tjera edhe probleme që mund të kenë besimet e ndryshme në vend. Raporti i DASH, 2018 mbi lirinë ndërkombëtare të besimeve në raste të caktuara tregon edhe kontributin konkret në asistime të specializuara lidhur me çështje të ndryshme të komuniteteve fetare. Një ndër këto është edhe ndihma e specializuar ofruar Ministrisë së Arsimit për të zhvilluar një politikë kombëtare si edhe për të hartuar manualin e mësuesve për mësimdhënie mbi fenë në shkolla publike dhe private. Programet edukuese të të rinjve të Ambasadës vijuan të përqendrohen në respektimin e besimit dhe diversitetit fetar. Programe të tjera kanë patur në fokus bashkësitë fetare dhe kujdesin për të rinjtë, për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm që lidhet me fenë tek të rinjtë.[18]

Lidhur me promovimin e vlerave shoqërore dhe dialogun ndërfetar kontribut kanë dhënë edhe konferencat e ndyshme të organizuara në Shqipëri (maj, 2018) që fokusojnë transformimin e shoqërisë përmes dialogut ndërfetar. Edhe në 2019 janë zhvilluar konferenca në kuadër të

[17] *Të jetojmë së bashku, të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në Evropën e shekullit 21: Raport i Grupit të Personave të Shquar të Këshillit të Evropës*, 2011, f. 5.

[18] International Religious Freedom Report for 2018: *Report on International Religious Freedom: Albania*, United States Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor, f. 2 https://www.state.gov/reports/2018-report-on-international-religious-freedom/albania/

dialogut ndërfetar duke trajtuar temat e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri, temat e politikave publike për administrimin e diversitetit dhe bashkëjetesës së pakicave në sistemin arsimor, etj.[19]

Ky unifikim strategjish dhe planesh veprimi dhe praktikash ndërgjegjësimi tregon për rrezikun e këtyre problematikave nga njëra anë dhe sigurinë që duhet të mundësojnë institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare për t'i neutralizuar apo minimizuar ato sidomos për grupmoshat shkollore, të cilat mund të jenë më të rrezikuara për shkak të faktorëve të ndryshëm.

Në këtë pikëpamje është shumë i rëndësishëm **ndërgjegjësimi i shoqërisë,** sidomos i nxënësve të shkollave të mesme, ndaj respektit të ndërsjellë për familjen dhe bashkëmoshatarët, për gjithëpërfshirjen, për ndihmën ndaj atyre në nevojë, për respektimin e pakicave dhe diversitetit, tolerancës fetare, kulturës së tjetrit etj. Një qasje e tillë inkurajohet dhe propozohet të **realizohet** në këtë udhëzues përmes zhvillimit të veprimtarive edukative konkrete lidhur me letërsinë.

Mësuesit shihen si një figurë shumë e rëndësishme në këto nisma parandaluese. Ato janë pjesë e pazëvendësueshme e strategjisë së suksesit të arsimit cilësor. Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, njeh dhe përkrah rëndësinë e arsimit cilësor për të adresuar këtë fenomen.[20] Edhe rekomandimet e Komisionit Europian rekomandojnë rishikimin e programeve shkollore në të gjitha nivelet, ku të përfshihen materiale që kanë të bëjnë me tolerancën, respektimin e dallimit dhe kontributet që japin minoritetet etnike në shoqëri. Mësuesit gjithashtu duhet të përfitojnë formim të nevojshëm në këtë drejtim.[21]

Përse me letërsinë?

Sepse letërsia, si *arti i fjalës, ka në esencën e saj njeriun, eksperiencat e tij jetësore dhe raportet që ai ndërton me veten, të tjerët, botën.*[22] Në raport të caktuar me shoqërinë dhe njeriun si individ i saj ajo ka disa funksione praktike :

- ✓ *Provokon kënaqësi dhe ndikon në krijimtari*;
- ✓ *Zhvillon imagjinatën njerëzore;*
- ✓ *Zhvillon aftësi specifike;*
- ✓ *Pasuron botën shpirtërore;*
- ✓ *Bëhet burim dijesh.*

Duke shfrytëzuar këto funksione konkrete të saj, letërsia dhe puna me të përmes mësuesve që do të organizojnë një seri aktivitetesh, do të jetë një mënyrë përplotësuese në

[19] http://icid.beder.edu.al/
[20] *Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së* , 2015
[21] Valbona Nathanaili. Rekomandimet e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe intolerancës në raportin e tij të tretë për Shqipërinë, Këshilli i Evropës, 9 qershor 2015 https://www.valbonanathanaili.com/rekomandimet-e-komisionit-evropian-kunder-racizmit-dhe-intolerances-ne-raportin-e-tij-te-trete-per-shqiperine/
[22] Edlira Macaj. *Letërsi, ab initio*. Tiranë: Albas, 2019, f. 30, 31

linjën e strategjive dhe politikave konkrete për parandalimin e ekstremizmit në tërësi dhe në mënyrë të veçantë atij të dhunshëm. Sot ekstremizmi është një rrezik për të gjithë shoqëritë.

Rraporti i BE-së 2010, që kishte çështjen e ekstremizimit në fokus, aktorë të parë të ndryshimit, të problemeve të intolerancës dhe diskriminimit, **vendosi arsimtarët**[23]. Në rekomandimet e tij të veçanta nxiten arsimtarët për të zhvilluar *"kompetencat ndërkulturore"* si një element bazë të kurrikulave shkollore, si dhe t'i shtrijnë këto përtej arsimimit formal, në ambiente jo formale si muze dhe institucione kulturore, aktivitete kulturore dhe festivale, dhe në veçanti në media. [24] Edhe organizimet e mëvonshme në vend (konferencat, seminaret, projektet e ndryshme, të cituara më lart) u japin mësuesve një rol të rëndësishëm në menaxhimin e problemeve që sjell ky rrezik për grup moshat shkollore. Nga ana tjetër raportet e fundit edhe pse njohin disa arritje, e cilësojnë fushën e arsimit në Shqipëri me përgatitje të moderuar, ndaj rekomandojnë që për arsimin parauniversitar në Shqipëri duhet të implementohet një strategji e cila të sigurojë gjithëpërshirjen në të gjithë nivelet, si në zonat urbane edhe ato rurale.[25]

Organizimi i aktiviteteve letrare bazuar në vlerat themelore të shoqërisë dhe të demokracisë, do të ketë në fokus edhe çështjen e tolerancës fetare, pasi "*Kur mostoleranca dhe diskriminimi kanë bazë fetare, grupet dhe drejtuesit fetarë kanë përgjegjësi të veçantë për t'i luftuar ato".*[26] Ndaj ky udhëzues do të konsiderojë të gjitha mundësitë për të promovuar vlerat themelore shoqërore përmes propozimit të modeleve konkrete. Kjo, sepse radikalizimi nuk është dukuri e izoluar dhe e panjohur në Shqipëri. Edhe për të shmangur radikalizimin janë bërë përpjekje, trajnime apo projekte të cilat kanë mision ndërgjegjësimin dhe shpjegimin e rreziqeve dhe luftën për parandalimin e tyre.[27]

Manuale, module apo materiale të ndryshme trajnimi për parandalimin e ekstremizmit sugjerojnë bashkëpunimin e aktorëve që marrin pjesë në fushën e edukimit në shkollat komunitare;. Çelësi i suksesit shihet te bashkëpunimet. *Prindërit, komuniteti dhe stafi i shkollës janë partnerë të rëndësishëm dhe të barabartë në vendimmarrjet që ndikojnë në cilësinë e shkollës dhe arritjet e nxënësve. Ata së bashku mund të informojnë, ndikojnë dhe krijojnë politika, praktika dhe programe në dobi të suksesit të nxënësve.*[28]

Në serinë e aktiviteteve që propozon ky udhëzues do të ndihmohen mësuesit, për të drejtuar aktivitetetet dhe për t'i bërë ato të hapura për një klimë bashkëpunimi, sipas kontributit

---

[23] *Të jetojmë së bashku, të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në Evropën e shekullit 21: Raport i Grupit të Personave të Shquar të Këshillit të Evropës*, 2011, f. 25

[24] *Të jetojmë së bashku, të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në Evropën e shekullit 21: Raport i Grupit të Personave të Shquar të Këshillit të Evropës*, 2011, f. 67.

[25] *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions*, report, 2019, f. 87, aksesuar në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf

[26] *Të jetojmë së bashku, të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në Evropën e shekullit 21: Raport i Grupit të Personave të Shquar të Këshillit të Evropës*, 2011, f. 48

[27] *Radikalizimi fetar dhe esktremizmi i dhunshëm në Shqipëri projektit "Parandalimi i radikalizmit fetar tek të rinjtë" , IDM, Tiranë, 2015*

[28] "Manual trajnimi parandalimi i esktremizmit të dhunshëm", Projekti: "A Caravan for Social Challenges! A Caravan for your empoëerment" i zbatuar nga "Open Doors", 14-18 maj 2018. f. 29

profesional dhe etik të secilit partner pjesëmarrës (mësues, nxënës, prind, psikolog, përfaqësues fetar, etj.)

Ndaj orientimi i mësuesve përmes këtij manuali, për të iniciuar një seri aktivitetesh edukuese për parandalimin e ekstremizimit të dhunshëm përmes veprave letrare, është:

- një nevojë (për shkak të mungesave në këtë drejtim) në kuadër të strategjive dhe politikave ndërkombëtare;
- nevojë për menaxhimin profesional të ndërhyrjeve në ndërgjegjësimin e komunitetit social, por në veçanti në moshat shkollore.

E rëndësishme është që format e reja të propozuara përmes këtyre veprimtarive në këtë udhëzues të japin rezultate konkrete në formimin e nxënësve me nxënie të suksesshme dhe për t'u bërë qytetarë të denjë në të ardhmen. Sot është e nevojshme të përgatiten nxënës të cilët udhëhiqen nga vlerat themelore qytetare: toleranca, mirëkuptimi, gjithëpërfshirja, respekti reciprok etj, pasi vetëm edukimi përmes vlerave siguron një edukim të mirë. Vlerat kanë një rol kryesor në teorinë e të nxënit dhe aktivitetet praktike në shkollë në dy mënyra:

- *Së pari, shkollat dhe mësuesit, krahas familjes, medias dhe bashkëmoshatarëve, kanë një ndikim të madh në zhvillimin e vlerave të fëmijëve.*
- *Së dyti, shkollat pasqyrojnë dhe unifikojnë vlerat e shoqërisë dhe i detyrohen ekzistencës së saj për faktin se shoqëria e vlerëson arsimin, pra vetë shoqëria përmes arsimit vepron në zhvillimin e saj të mëtejshëm.*[29]

Ndaj udhëzimet për mësuesit mbi këto veprimtari do të ndihmojnë vetë nxënësit të përvetësojnë vlerat, të ecin drejt të mirës, të mbajnë larg gjuhën e urrejtjes dhe të reflektojnë mbi atë se çfarë është e rëndësishme dhe merr kuptim të vërtetë në jetë.

PJESËMARRËSIT DHE BASHKËPUNIMI MES TYRE

1. Bashkëpunimi shkollë/familje (mësues-psikolog/ -nxënës-prind)

Edhe pse në shkollë nxënësit nisen për t'u pajisur me dije dhe për t'u përgatitur me një sërë aftësish, ata vijnë me një parapërgatitje edukative prej familjes së tyre. Ekziston një raport besimi mes familjes dhe shkollës, pasi objekti i përgatitjes është i përbashkët: fëmija nxënës. Roli primar edukues është i familjes dhe në po të njëjtën rëndësi shfaqet edhe ai i shkollës.

Prandaj ky udhëzues u drejtohet prindërve të dytë, mësuesve, për t'i udhëzuar ata me kompetenca të reja ndërvepruese në punën e tyre për t'i mbrojtur të rinjtë para rrezikut të ekstremizmit me anë të të kuptuarit të vlerave që prodhojnë veprat letrare. Nga ana tjetër, psikologët e shkollave ndihmojnë në këtë drejtim pasi, edhe për shkak të formimit të tyre profesional ata mund të lexojnë dhe të identifikojnë lehtësisht shenjat e para të ekstremizmit të dhunshëm apo radikalizimit mes të rinjve dhe përmes metodave apo ndihmës speciale.

[29] J.M.Halsted, J. Taylor. "Values in education and education in values." London: Psychology Press, 1996, f. 5

Nëpërmjet këtij zinxhiri ku vendosen marrëdhënie besimi dhe profesionalizmi mes palëve që marrin pjesë në edukimin e të rinjve mund të arrihet në rezultate më të prekshme, të cilat vijnë më shpejt nëse mes palëve ka:

- ✓ **Koordimin dhe shkëmbim** informacioni. Informacioni mund të përcillet me mënyra të ndryshme nga shkolla te familja dhe anasjelltas;
- ✓ **Respektim dhe përfshirje** të të gjithë nxënësve pa dallime në aktivitetet e propozuara. Asnjë grupim social, nuk duhet ta ndiejë vetën të veçuar dhe të papërfshirë;
- ✓ **Vëmendje** që të identifikohen problematikat përpara se të bëhen të pakapërcyeshme. Me anë të bordit të përfaqësimit prindërit vihen në kontakt me situatat dhe problematikat që prodhon sfida e edukimit.
- ✓ **Dakordësi** në vendimarrje mbi procesin edukues. Ky element i bashkëpunimit arrihet nëse komunikimi në vijim ka krijuar klimë mirëkuptimi mes tyre.

2. Bashkëpunimi shkollë/familje/komunitet

(mësues-psikolog/-**nxënës**/prind/përfaqësues komuniteti fetar)

Mekanizmit të skemës së mësipërme u shtohet si një ndihmë për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit edhe zëri i përfaqësuesve fetarë, si pjesë e komunitetit. Bashkëpunimi midis këtyre partnerëve është një çelës komunikimi dhe mirëkuptimi në drejtim të edukimit cilësor.

Udhëzuesi përmban edhe përgatitjen e aktiviteteve të veçanta, bazuar në librat e lartpërmendur, në të cilat do ta gjejnë dhe do të luajnë rolin e tyre të gjithë partnerët që përfshihen direkt dhe indirekt në edukimin e të rinjve. Kjo për të dhënë sigurinë që shkollat në procesin e edukimit nuk janë vetëm dhe të izoluara, por të bashkërenduara me pjesët e tjera të komunitetit. Mbajtja në koherencë dhe përditësimi me informacione mes të gjithë këtyre partnerëve e bëjnë punën e mësuesve më rezultative ndaj nxënësve. Nga ana tjetër nxënësit ndihen më të sigurtë dhe të mbrojtur në këtë pjesëmarrje. Përfaqësuesit e komuniteteve fetare kanë mundësinë të tejçojnë mesazhet e paqes ashtu siç janë, pa rënë në rrezikun e deformimeve dhe politikave ideologjike ekstremiste. Me rëndësi është mbajtja në nivel konstruktiv e dialogut të ndërsjellë, e diskutimit për çështje kurrikulare, extrakurrikulare dhe personale mes familjes dhe shkollës. Roli i psikologëve dhe i përfaqësuesve fetarë të komunitetit sigurisht që forcon kohezionin mes palëve. Edhe kjo skemë mund të funksionojë shumë mirë nëse të gjithë përfshihen me rolet përkatëse të profesionalizmit në diskutimet reale, po aq edhe në aktivitete të caktuara. Nga ky bashkëpunim mes të gjithë palëve mund të arrihet:

- ✓ **Njohje dhe mbështetje.** Palët përmes afrimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete njihen më mirë me rolin përfaqësues së secilit;
- ✓ **Përcaktim i kontributit**. Në çdo sipërmarrje apo pjesëmarrje konkrete secili nga bashkëpunuesit ka një rol dhe një kontribut. Kjo bëhet transparente në

specifikimin për secilin rast ku nevojitet ekspertiza profesionale për një çështje të caktuar;

- ✓ **Monitorim.** Secili nga partnerët mbështetës di të vlërësojë dhe të shikojë se cilat janë pritshmëritë, problemet, sfidat etj.;
- ✓ **Propozime dhe sugjerime** që mund të diskutohen përmes një forumi të hapur.

TIPOLOGJIA DHE SHPËRNDARJA E AKTIVITETEVE (faza përgatitore)

Aktivitetet që propozohen në këtë udhëzues duke patur parasysh të mësuarit me kompetenca, për të arritur rezultate në promovimin e vlerave themelore qytetare dhe parandalimin e formave ekstremiste, bazohen në tre orientime didaktike:

1. *Konjitive*
2. *Socio-emocionale*
3. *Qëndrime ose pikëpamje*

Grupimi i aktiviteteve do të ketë si synim edukimin përmes vlerave që burojnë nga veprat e përzgjedhura. Kjo do të thotë se një vepër letrare gëzon statusin e përfshirjes së saj, zbërthimit, analizës, reflektimit mbi të, rikrijimit bazuar në të në disa grupe veprimtarish. Kjo falë burimeve të pashtershme më të cilat ushqen teksti letrar e kritik.

Aktivitetet që do fokusohen te të mësuarit konjitiv, pra njohës do të kenë objektiv zhvillimin e të menduarit kritik dhe aparatin analitik. Kjo ka të bëjë me njohurinë që përfitohet nga trajtimi i temave të përcaktuara me rëndësi lokale ose globale, me ndërlidhjen dhe njohjen mes vendeve dhe shoqërive të ndryshme.

Ky orientim **didaktik** do t'i aftësojë nxënësit:

- ✓ të njohin format e diskutimeve, manipulimeve, paragjykimeve;
- ✓ të përpunojnë mendimin përmes fakteve;
- ✓ të ndërtojnë pikëpamje të pavarura;
- ✓ të njihen dhe të parandalojnë lloje të ndryshme shfaqjesh të ekstremizmit apo devijimeve të tjera në sjellje.

Orientimi për **stimulimin e sferës socio-emocionale** do të lidhet me aktivitetet që merren me përgjegjësinë dhe ndarjen e vlerave humane, solidarizohet dhe respekton diferencat mes grupeve shoqërore, duke u mbështetur te kompetencat ndëkulturore. Këtu do të futen ato aktivitete me anë të të cilave kuptohet rëndësia e vlerave themelore, ndihet respekti reciprok për dallimet kulturore, fetare të komunitetit.

Orientimi drejt ndërtimit të pikëpamjeve të pavarura stimulon reflektivitetin e nxënësve në procesin e angazhimit gjatë aktivitetit, rritjen e vetëvlerësimit dhe përgjegjësinë për të ndërtuar një qëndrim argumentativ duke respektuar larmishmërinë dhe pikëpamjet e ndryshme.

MODALITETET E ZBATIMIT TË AKTIVITETEVE

Përtej grupimit të librave artistikë, për secilin syresh do të zhvillohet një skedë parapërgatitore e cila do të orientojë mësuesit sesi mund ta organizojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e parashikuar. Procesi i ndërtimit të skedave të aktivitetit, mbulon elementët kryesorë për të arritur objektivat e vendosur paraprakisht. Çdo aktivitet do të ketë/përmbajë:

- ✓ **Qëllim dhe objekt konkret**. Së pari çdo veprimtari përcakton se çfarë qëllimi ka në tërësi dhe me çfarë do të merret konkretisht. Në cilin grupim do të futet ai aktivitet? Çfarë do të kërkojë të promovojë? Të dyja duhen për të përcaktuar se çfarë duhet të synohet. Cila vlerë themelore qytetare do të promovohet përtej asaj estetike; a mund të bëhet me të një rikrijim artistik që kërkon mediumin artistik film apo mjete teknologjike? A është një *open day* dhe kërkon lëvizjen në një vend të caktuar për shkak të rëndësisë që merr në libër një kulturë apo qytet (lokalitet) i veçantë dhe duhet promovuar si vlerë për të rivlerësuar diversitetin dhe kuptuar më mirë identitetin? etj.
- ✓ **Kompetencat**. Aktivitetet mund të zhvillojnë njëkohësisht të mësuarit përmes disa kompetencave. Ka vepra letrare të cilat stimulojnë të menduarit kritik siç janë sprovat letrare duke propozuar gara të forta esesh tematike që u japin mundësi zhvillimit të ideve të reja. Ka vepra të cilat merren eskluzivisht me vlerat dhe ndasitë racore apo diskriminimet gjinore dhe kjo ndez diskutimet në grupin e debatit. Ka vepra të cilat ushqejnë imagjinatën dhe kërkojnë një rikrijim sipas fantazisë së nxënësit duke aktivizuar nxënësit e Klubit të dramës dhe e Klubit të filmit. Ka vepra letrare mes listës së sugjeruar të cilat kanë pasazhe të forta dramatike dhe mund të ndihmojnë nxënësit të realizojnë performancat e tyre teatrore, etj. Sipas temave, motiveve dhe vlerave që promovon një vepër letrare edhe nxënësit mund të punojnë me kompetencat që këto vepra diktojnë të zhvillohen.
- ✓ **Vendi/Njësia.** Është shumë e rëndësishme të përcaktohet ku do të zhvillohet ky aktivitet, por edhe cili grupim do ta marrë përsipër realizimin e tij. A është dramatizim dhe kërkon një inskenim dhe kostumografi? A është një orë e klubit të leximit dhe kërkon një sallë leximi në rrethin e paqes ku përzgjidhen pjesë të caktuara nga librat? Gjithsesi është menduar që pjesa më e madhe e veprave, për shkak të gjerësisë dhe potencialit të tyre artistik, mund të ndahet në detyra që mund të merren përsipër nga disa njësi njëkohësisht. Pra një vepër mund të japë mundësinë të realizohet në një veprimtari të plotë kur merret përsipër edhe nga grupi i dramës, edhe ai leximit, edhe ai i debatit e kështu me radhë, duke kryer secili një sipërmarrje të veçantë. Këto detyra i shpërndan mësuesi sipas prirjeve dhe aftësive të nxënësve, por edhe sipas dëshirës së tyre për të marrë përsipër diçka.
- ✓ **Zbatuesit/Pjesëmarrësit**. Këtu do jenë të përfshira dy katëgori. Zbatuesit do të jenë nxënësit e klubeve të ndryshme sipas ndarjeve që do t'u bëhen atyre paraprakisht, ndërsa pjesëmarrës për mbarëvajtjen e veprimtarisë do të jenë sipas rastit: mësuesit, drejtues të tjerë që mund të asistojnë teknikisht, psikologët duke ofruar ndihmën e tyre

profesionale, prindërit, por edhe përfaqësuesit fetarë kur të diskutohen veprat të cilat kanë në qendër çështje të besimit, sidomos për çështje të intolerancës fetare.

- ✓ **Mënyra e zbatimit**. Kjo i jep unicitetin çdo veprimtarie. Jo të gjithë librat mund të kërkojnë të njëjtin zhvillim. Ka libra të cilët e rezonojnë vlerën e tyre përmes kulturës së debatit dhe argumentit të plotë. Ka libra që kërkojnë një pikëvështrim tjetër atë të shprehjes përmes një rikrijimi, pra të përdorësh një art tjetër për të ilustruar vlerën e tij. Ka libra të cilët propozojnë krahasimet etj. Modalitetet e ndryshme të zhvillimit të veprimtarive do të sugjerohen sipas modeleve shembull në tabelat e mëposhtme.
- ✓ **Rezultatet**. Eshtë e rëndësishme që pas çdo hapi që ndiqet, rezultati të jetë i prekshëm në: të kuptuarit e vlerave të librave, të reflektuarit mbi problemet, mbi paraqitjen e zgjidhjeve dhe propozimeve, sugjerimeve, e kapërcimeve të vështirësive sipas rastit. Mund të jetë problem intolerance, mos respektim ndaj tjetrit, diskriminim për shkak të grupimit social etj. Në çdo rast nxënësi duhet të përftojë vlera dhe kënaqësi estetike dhe artistike, por sidomos të ndihet i përfshirë.
- ✓ **Koha**. Është mirë që planifikimi i aktiviteteve të bëhet me një kalendar të caktuar për t'u dhënë kohë pjesëmarrësve që të përgatiten rreth tyre, si edhe për t'i lidhur ato mundësisht me ditë të shënuara. Gjatë vitit shkollor mund të përgatiten 10 veprimtari të ndryshme (1 në muaj dhe një përmbyllës në fund) të cilat mund të shpërndahen në disa orë (4 orë një aktivitet (vetëm në nivel të shfaqjes, por jo të përgatitjes së tij që do të kërkojë ditë të tëra bashkëpunimi e reflektimi mes mësuesve të letërsisë dhe nxënësve), duke u futur në realizime të ndryshme, p.sh.: një vepër letrare mund të futet një orë në klubin e debatit, një orë në konkursin e eseve, një orë në play role, një orë në art etj., duke shqyrtuar vlerat e tij estetike, ose të shkrihen të tëra së bashku.

ROLI I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETET EDUKUESE

- ### Mësuesit

Në aktivitetet tradicionale të letërsisë (promovimet letrare, konkurset e interpretimit, etj.) organizimi dhe realizimi përgjithësisht përballohet nga vetë nxënësit dhe mësuesit. Ky udhëzues, përmes elementëve të rinj të ndërfutur në strukturën e çdo aktiviteti propozon një rol të veçantë për secilin pjesëmarrës dhe zbatues. Kjo për të krijuar gjithëpërfshirjen dhe marrjen e një rezultati për një punë ku përgjegjësitë e edukimit ndahen sipas rëndësisë së secilit aktor në proces. Propozimi i këtyre aktiviteteve synon përfshirjen e: mësuesve, nxënësve, prindërve, psikologëve, por të ftuar ose edhe pjesëmarrës mund të jenë edhe përfaqësuesit fetarë. Mësuesit e letërsisë kanë përgjegjësinë për të përzgjedhur mënyrën e zhvillimit të aktivitetit. Ai do të jetë në varësi të librit i cili do të aktualizohet me njërën ose disa nga format propozuese (nga klubi i librit, i dramës, i filmit, etj.) Për çdo aktivitet mësuesi:

- ✓ ndan detyrat, rolet për secilin pjesëmarrës

- ✓ kujdeset që secilit nxënës t'i ofrojë zbatimin e një detyre në përputhje me aftësitë dhe prirjet që ka ose shpreh vetë nxënësi
- ✓ duhet të sigurohet për gjithëpërfshirje
- ✓ të moderojë situatat dhe të ndjekë mbarëvajtjen e aktivitetit gjatë përgatitjes deri në finale, pasi një aktivtet mund ta ketë të gjatë kohën parapërgatitore
- ✓ të orientojë nxënësit mbi format e mundshme të zbatimit të një projekti
- ✓ të kordinojë punën mes grupeve të ndryshme nëse janë disa
- ✓ të krijojë mjedis dhe klimë miqësore me nxënësit
- ✓ të ndihmojë në rastet ku nxënësit kanë vështirësi për ekzekutimin e ndonjë detyre, etj.

Për arritjen e të gjithë këtyre objektivave mësuesit duhet të përdorin të gjithë aftësitë e tyre profesionale të fituara falë kualifikimit të tyre të vijueshëm dhe përvojës me nxënësit. Një ndër to është edhe teknika e '**teachable moments'**- momentet tipike të cilat thyejnë akullin dhe nisin në mënyrë të natyrshme diskutimin, por nga ana tjetër kërkojnë një kualifikim të mirë profesional të mësuesit. Kjo, pasi kërkohet shpjegimi i një koncepti të vështirë i cili duhet të vijë sa më i natyrshëm duke u parashtruar nga një paraqitje apo hedhjen e një pyetjeje në dukje si rastësi por që mundet ose duhet të lidhet me përvojat e dëgjuesit. E tillë p.sh.: është situata interesante e hapjes së aktivitetit që lidhet me librin *Princi i vogël -A është kjo një kapele?* Por ky është një libër i cili mund të futet në disa grupime aktivitetesh në varësi të objektit që do të trajtohet dhe në varësi të vlerës që do të promovohet.

Së dyti, mësuesit duhet të mësohen jo vetëm të drejtojnë dhe organizojnë, por në thelb të jenë edhe ata aktorë të diskutimeve që propozohen. Të dinë të: dëgjojnë, të pyesin, të pranojnë kritika ndaj deklarimeve të tyre, (mendimin ndryshe), të tregojnë ata së pari, hapur, tolerancën, të mos gjykojnë e paragjykojnë, të shikojnë nga perspektiva e tjetrit, të bëjnë komente të shkurtra për t'i lënë hapësirë nxënësve mes tyre. Të kryejnë rolin e thjeshtuesit, ndërmjetësit për garantimin e të drejtave diskutuese mes palëve kur janë në aktivitetet e diskutimeve të hapura, të shmangin pozicionimet e tyre, të mos mbiinterpretojnë, të jenë të fokusuar, të kenë kujdes në identifikimin e sjelljeve që mund të dalin jashtë diskutimit tematik, të inkurajojnë debatin konstruktiv dhe po aq t'i inkurajojnë nxënësit të jenë vetvetja.

- ## Nxënësit

Nxënësit janë thelbi i çdo aktiviteti. Të gjitha modalitetet mund të zbatohen nëse nxënësit ndihen të përfshirë; nëse u jepet një detyrë e cila ndez tek ata dëshirën për të punuar; nëse kanë një mjedis ku të ndihen të barabartë dhe nuk bëhen dallime; nëse edhe pasi dështojnë në një projekt u jepet mundësia të provojnë veten sërsish, etj.

Nëpërmjet modeleve që prezanton mësuesi, ata, përmes pjesës praktike do të ushtrojnë një sërë kompetencash të cilat do të zhvillohen edhe më shumë gjatë punës konkrete (rolit që kanë) me projektin në të cilin do të angazhohen. Kështu nëse do të aktivizohet për një libër të caktuar aktiviteti i debatit atëherë menaxhimin e marrin nxënësit që priren ndaj kompetencës së të menduarit kritik; nëse po për të njëjtin libër është përcaktuar të krijohet edhe një ekspozitë teamtike pikture apo video-kolazhi, atëherë aktivizohen nxënësit të cilët janë pjesë e grupit artistik të pikturës ose filmit, të cilët me anë të teknologjisë mund të bëjnë një prodhim artistik për rastin. Mundet që një libër të ketë mundësinë të zhvillohet nga nxënësit në disa forma ku

grupet kordinohen për t'u lënë hapësirë njëri tjetrit. Ndaj gjithëpërfshirja e nxënësve është prioritet i aktiviteteve edukuese të letërsisë, pasi përveç zhvillimit të kompetencave, siguron bashkëpunimin mes tyre, respektin për punën e njëri-tjetrit, si edhe tolerancën mes tyre.

- **Prindërit**

Në fillim të vitit shkollor, prindërit duhet të njihen me kalendarin e aktiviteteve që organizohen nga shkolla, me qëllimin e tyre si dhe të bëhen pjesëmarrës përmes diskutimeve në çeshtje që i prekin konkretisht në marrëdhëniet e përditshme me fëmijët e tyre. Pasi të njihen me këtë kalendar, ata mund të ftohen edhe të japin sugjerime mbi to paraprakisht gjatë takimeve periodike që kanë me mësuesit e letërsisë. Kjo i ndihmon të gjithë drejt një vlere të re njohëse, perceptuese dhe vlerësuese: drejt mendimeve të hapura. Duhet të sigurohet pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja e tyre në aktivitetet edukative.

Nga ana tjetër libra të caktuar kërkojnë edhe një diskutim përtej orientimit konjitiv, empatik dhe pikëvështrimeve adoleshenciale, në qendër të të cilave është padyshim mësuesi i letërsisë. Kështu roli i prindërve është i rënddësishëm në mbarëvajtjen e aktiviteteve. Librat me të cilët do të punojnë nxënësit duhet të jenë të qarta edhe për vetë prindërit. Me njohuritë dhe eksperiencën e tyre ata mund të diskutojnë paraprakisht temat e trajtuara në libra dhe të ndërtojnë kështu një situatë të cilën ta kenë të njohur tematikisht dhe të vlerësuar më parë nga ana estetike. Gjatë aktivitetit ata do të jenë në koherencë të plotë dhe nuk do të kenë paqartësi, por edhe do të jenë të informuar për llojin e aktivitetit dhe të rolit të fëmijëve të tyre. Kjo vlen jo vetëm për aktivitetet të cilat mund të kenë pikë të fortë debatin kur trajtohen tema si diskriminimi, toleranca etj., por edhe për ato me natyrë me eksperimentale. Prindërit kështu do të zbulojnë një tjetër anë të fëmijëve të tyre, në punë të pavarur. Në aktivitete ata mund të marrin pjesë si shikues, vlerësues por mbase edhe si kontribues realë nëse është e nevojshmçe (sidomos në rastet kur tema e aktivitetit lidhet natyrshëm me një çeshtje që kërkon zgjidhje në sjelljen shoqërore të fëmijës së tij). Kjo për të thyer barrierat mes brezave dhe siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive, jo vetëm si vëzhgues, por si pjesëmarrës në organizim, në ndonjë rol, në asistime teknike etj.

- **Psikologët**

Puna e psikologut nëpër shkolla është përcaktuar dhe rregulluar me ligj. Ai është një figurë shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e procesit të edukimit. Komunikimet ndërpersonale, këshillimi dhe konsultimi janë praktika të punës së tij me nxënësit. Megjithatë shtrirja e profesionalizmit të tij mbulon raporte edhe më të gjera. Si njohës i mirë i tipave psikologjikë dhe socialë, psikologu jo vetëm që mund të jetë pjesëmarrës në aktivitetet e letërsisë të cilat do të kenë forma të ndryshme zhvillimi, por mund të luajë rol edhe në organizimin e tyre, përmes kordinimit të marrëdhënieve mes nxënësve gjatë përgatitjes së këtyre aktiviteteve. Ai mund të ndihmojë me këshilla, me zbutje të tensioneve nëse hasen të tilla, me instruksione efektive. Ai mund të pikasë më me lehtësi diversitetet dhe largimet mes bashkëmoshatarëve dhe mund të ndërhyjë në kohë.

Kontributi i tij si pjesëmarrës në aktivitet mund të jetë edhe me shpjegimin e komplekseve psikologjike që kanë personazhet e librave, në rastet kur nxënësit kanë vështirësi për t'i zbërthyer ata. Në këtë mënyrë roli i tij merr një rëndësi të madhe pasi është mediator mes nxënësve me njëri tjetrin, mes mësuesve dhe nxënësve në raste të caktuara, mes shkollës dhe familjes, për të

promovuar sukseset e nxënësve, apo për të ndërhyrë dhe parandaluar kriza të pikasura më parë nga ai. Si pjesëmarrës në aktivitet ai bëhet një ndërmjetës mes prindërve dhe fëmijëve të tyre që ata të njohin më mirë nevojat e fëmijëve të tyre .

- **Përfaqësuesit fetarë**

Shkollat janë institucione dinamike, jo statike, gjë që nënkupton zhvillimin e formave të reja të edukimit në varësi të situatave, për të siguruar më të mirën e mundshme për nxënësit e saj. Pas viteve ’90-të në Shqipëri shpesh është diskutuar edukimi fetar në shkolla. Deri tani shkollat publike shqiptare nuk e përfshijnë në kurikulën e tyre edukimin fetar. Përfaqësuesit fetarë e pretendojnë një gjë të tillë, në emër të tejçimit të vlerave morale. Feja është zgjedhje e lirë për secilin dhe toleranca fetare në Shqipëri është një vlerë më vete. Për të ruajtur këtë tolerancë është e nevojshme që në nivele të ndryshme shkollore kjo vlerë të promovohet. Përfaqësuesit fetarë me mesazhet e tyre për paqen, besimin, tolerancën, reciprocitetin luajnë një rol pozitiv në edukimin e komunitetit, por edhe të të rinjve të cilët studiojnë në shkollat e mesme.

Në aktivitete të caktuara të letërsisë, ka libra të veçantë që trajtojnë tema të edukimit, diskriminimit apo tolerancës fetare. (*Unë jam Malala, Babeli, Fundamentlist padashje*, etj).) Në këto raste, e në të tjera të ngjashme me to, roli aktiv i përfaqësuesve fetarë, për promovimin e vlerave themelore dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, do të ishte ndërhyrje pozitive, dhe komuniteti do të ishte më i përfaqësur dhe i përfshirë. Forma e ndërhyrjes mund të jetë nëpërmjet një viedomesazhi, ose pyetjeve-përgjigjeve informuese.

AKTIVITETET DHE MEDIUMET (teknikalitete)

Çdo aktivitet është konceptuar që të ketë një ose disa modalitete realizimi. Një aktivitet që merr përsipër zbërthimin e një libri artistik mund ta bëjë këtë në një ose disa mënyra. Për këtë nevojiten edhe disa mjedise, grupe dhe teknikalitete të cilat pasurojnë në vetvete aktivitetet dhe mund të jenë risi në to.

Veprimtaria 1- Libri artistik *Çunat nuk qajnë* është menduar të zhvillohet si hapje e ciklit të aktiviteteve në muajin shtator. Ai mund të zhvillohet në vendin ku ushtron veprimtarinë klubi i leximit. *Çunat nuk qajnë* mund te ketë tre modalitete zhvillimi si aktivitet i marrë përsipër nga:

- ✓ **Klubi i leximit**: Si lexim pjesësh dhe komentime të ndara më parë sipas temave dhe motiveve, ku zbatues janë vetëm nxënësit. Ata lexojnë pjesë dhe komentojnë mbi to.
- ✓ **Klubi i debatit**: Si debat i fortë me disa pjesë (sipas pyetjeve të përcaktuara në skedat përkatëse). Zbatues janë nxënësit, por mund të ndërhyjnë edhe psikologët dhe prindërit . Nëse rolet e këtyre dy të fundit do të aktivizohen atëherë do të dakordohen paraprakisht për llojin e ndërhyrjes.

Risi-mediumi elektronik: nxënësit do të krijojnë një ose disa grupe chat-i, administrator i të cilit/ëve është mësuesi (dhe psikologu nëse është e nevojshme). Në këtë format ata do të diskutojnë mbi temat e trajtuara në libër, siç bëjnë në bisedat e tyre të përditshme me nëjri tjetrin. Këtu roli drejtues i mësuesit të letërsisë është shumë i rëndësishëm dhe roli vëzhgues i psikologut është shumë i dobishëm. Në fund të aktivitetit diskutohen rezultatet e arritura përmes tre formave të zhvillimit. Shqyrtohen përmes krahasimit, përfitimet dhe kufizimet e tre metodave.

Veprimtaria 2: *Unë jam Malala*, është një histori e cila propozon angazhimin e:

- ✓ **klubit të debatit**, i cili do të orientohet në disa tema. Përmes shtjellimit të temave do të dilet në përgjithësime dhe krahasime. Në mes të aktivitetit mund të ndihet e nevojshme për një ndërhyrje etike të mendimit të psikologut apo përfaqësuesit fetar rreth tolerancës dhe pranimit të diversitetit dhe vlerave të tjera lidhur me identitetin personal e kulturor.

Veprimtaria 3: *Babeli* , do të zbërthehet përmes angazhimit të

- ✓ **klubit të debatit**, i cili do të trajtojë temën e terrorizmit dhe parasë nga njëra anë dhe miqësisë dhe dashurisë nga ana tjetër
- ✓ **klubit të leximit**, i cili do të ilustrojë me shembuj , pjesë të caktuara të temave të mësipërme. Pjesëmarrës mund të bëhen edhe përfaqësuesit fetarë me mesazhe sensibilizuese për çështjen e terrorizmit.

Veprimtaria 4: *E bardha dhe e zeza*, realizohet përmes

- ✓ **konkursit të eseve**. Ky konkurs i përgatit mendimin kritik nxënësve dhe i përmirëson mënyrën e të shkruarit mbi çështje të rëndësishmë si racizmi, toleranca, mirëkuptimi etj. Pjesëmarrja e psikologut me vlerësimin e tij për esenë më përfaqësuese i jep një dimension më të gjerë aktivitetit.

Veprimtaria 5: *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, mund të realizohet nga:

- ✓ **klubi i leximit** , nxënësit e këtij klubi interpretojnë pjesë të ndryshme të librit. Ky klub mund të bashkëpunojë me
- ✓ **klubin e filmit**, i cili mund të krijojë një kolazh pjesësh nga realizimet e ndryshme kinematografike kombëtare dhe ndërkombëtare që ka frymëzuar libri.
- ✓ **biblioteka e shkollës**. Në këtë mjedis nëpërmjet një varianti prezantues, mund të paraqitet 'Një guidë letrare dhe kulturore, për të njohur vendin, veten dhe 'tjetrin'. Nëpërmjet tekstit zbulohen dhe identifikohen vendet ku shkon gjenerali duke krijuar dhe paraqitur një hartë digjitale. Këtu mund të vijnë në ndihmë mësuesit e historisë në forma të ndryshme, ose si ndërhyrje gjatë prezantimit ose me materiale të përgatitura paraprakisht nga nxënësit në mënyra të ndryshme (powerpoint)
- ✓ **laboratori i informatikës**. Do të ndihmojë për të hedhur në programe të ndryshme itenerarin e lëvizjes së gjeneralit për të krijuar hartën letrare

Risi: krijimi i një **faqeje Web**. Kjo faqe do të ketë në brendësi disa rubrika që do të realizohen nga nxënësit e grupeve të mësipërme.

Veprimtaria 6: *Kronikë në gur*, realizohet nga:

- ✓ **klubi i debatit**, që do të diskutojë për ndikimet e fëmijërisë te njeriu. Këtu mund të ndërhyjë psikologu me të dhëna shkencore mbi fëmijërinë, kujtimet, mbresat etj.
- ✓ **klubi artistik**, mund të vendosë të bëjë një *tour eksplorues* në shtëpinë e lindjes së shkrimtarit dhe në atë muze. Nxënësit e këtij klubi mund të ndërtojnë një ekspozitë pikture me krijimet nga mbresat e vizitave, me temë personalen (sendet, librat, vendet, etj)

Risi: ekspozitë virtuale e pikturave frymëzuar nga udhëtimi didaktik

Veprimtaria 7: *Tre sprova mbi letërsinë botërore: Eskil, Dante, Shakespeare* do të jetë një aktivitet i ngjeshur propozuar për t'u realizuar nga:

- ✓ **Klubi i debatit** i cili do të merret me konceptet e së drejtës, hakmarrjes, vetëgjyqësisë, ndëshkimit
- ✓ **Klubi i dramës** do të vërë në skenë pjesë nga autorët
- ✓ **Konkursi i eseve tematike** , do të punohet për ese me tema që prodhojnë veprat e tre autorëve
- ✓ **Klubi artistik dhe TIK**. Bashkëpunimi mes klubit artistik dhe specialistëve TIK mund të sjellë një risi për të ilustruar zbatimin e njërës prej formave të këtij aktiviteti. P.sh.: nëse nxënësit i referohen një tragjedie të Eskilit: *Prometeu* do të gjejnë nëpër pikturat botërore të gjithë paraqitjet artistike të Prometeut. Mund të realizohet një film me minutazh të shkurtër duke përdorur aplikacione të ndryshme si stop motion studio, playmobil, etj. që mund të ilustrojnë paraqitjen e poetikës së figurës në kohë të ndryshme kulturore.
- ✓ Klubi i filmit mund të bëjë një përmbledhje videosh me inskenimet dramatike dhe realizimet filmike të veprave.

Risi: filmi i animuar.

Veprimtaria 8: *Princi i vogël*, mund ta zhvillojë aktivitetin përmes:

- ✓ **Klubit të artit,** i cili mund të realizojë një ekspozitë pikture me temat që dalin nga leximi i veprës
- ✓ *Klubit të leximit*, të komentojë mbi temat që gjeneron libri: miqësia, marrëdhëniet ndërpersonale, rritja, vlerat, toleranca, ëndrrat.

Veprimtaria 9: *Gjuetari i balonave*, Khaled Hossein; *Pa zemër në kraharor*, Mira Meksi; *Fundamentalist pa dashje*, Mohsin Hamid dhe *Alkimisti*, Paolo Coelho, janë libra artistikë, baza e të cilëve do të jetë 'udhëtimi si metaforë' . Ata do të merren përsipër të realizohen nga :

- ✓ **klubi i leximit** do të diskutojë mbi autorët dhe librat biografikë, mbi ndikimet e ngjarjeve në jetën e njeriut etj.
- ✓ **klubi i filmit,** mund të realizojë një video mbi përvojat e përjetimit të secilit libër; për librin *Gjuetari i balonave,* videoja mund të ketë tre pjesë: *përvojën e vetë leximit* në të cilën nxënësi shpreh me video këtë përvojë. Pjesa e dytë mund të përmbledhë konkluzionet e diskutimeve mbi librin nga nxënësit e klubit të leximit. Pjesa e tretë e videos mund të pasurohet me ritregimin nga vetë nxënësit të një përvoje vetjake të fëmijërisë së tyre.
- ✓ **klubi i debatit.** Ky klub mund të diskutojë apo të bëjë role-play mbi temat që ndërtojnë librin *Fundamnetalist pa dashje*.
- ✓ **klubi krijues** mund të realizojë një ekspozitë me foto dhe fakte biografike të autorit të librit *Gjuetari i balonave.* Ky klub mund të realizojë gjithashtu një ekspozitë digjitale krahasuese mes vendeve që përshkruhen në novelën *Pa zemër në kraharor* dhe pikturave të Frida Kahlo-s që citohen në libër. Nxënësit e këtij klubi për librin *Alkimisti* mund të bëjnë krahasime me projektin filmik, mund të rikrijojnë: poezi apo përshkrime, konfesione frymëzuar nga libri apo personazhi i tij.

Të gjitha këto aktivitete mund të realizohen edhe përmes formave të tjera në situata të veçanta, siç ishte edhe situata pandemike e këtij viti, periudhë gjatë së cilës shkollat nuk mund të ishin të hapura. Për t'i paraprirë një skenari të mundshëm në shtator, aktivitetet edukative të letërsisë duhet të sigurojnë një formë alternative për t'u zbatuar. Falë teknologjisë dhe aplikacioneve të ndryshme, sot mjedisi digjital mundëson jo vetëm komunikimin, por edhe realizimin e projekteve të cilat janë po aq efektive sa janë edhe aktivitetet në praninë e njëri tjetrit.

Për këtë arsye 12 titujt e propozuar për të promovuar vlerat themelore qytetare dhe për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm mes të rinjve janë menduar të zhvillohen në modalitetet e mësipërme. Të ndara sipas grupeve zbatuese aktiviteti mund të zhvillohet edhe në platformat online, nëse situata e kushtëzon diçka të tillë:

- ✓ **Klubi i leximit, Klubi i debatit.** Nxënësit e këtyre klubeve mund t'i realizojnë performancat e tyre në platformat: google classrom, zoom, etj.
- ✓ **Esetë fituese** mund të përpunohen në aplikacione të ndryshme për t'u kthyer në sekuenca videosh, të shoqëruara me zë e figurë dhe me një bazë muzikore, si një eksperimet audio-vizual.
- ✓ **Faqja Web** e 'gjeneralit' mund të aksesohet kudo
- ✓ **Klubi artistik (piktura) dhe filmik** i realizojnë projektet e tyre në programe të caktuara të cialt mund te aksesohen nga të gjithë pjesëmarrësit e aktiviteteve.

NDËRTIMI I SKEDËS DHE KALENDARI I VEPRIMTARIVE

Nr.	TITULLI I LIBRIT/AUTORI	VEPRIMTARI	MUAJI
1	*Çunat nuk qajnë*/ Malorie Blackman	Klubi i leximit Klubi i debatit Diskutim në chat	Shtator
2	*Unë jam Malala*/ Malala Yousafzai	Klubi i debatit	Tetor
3	*Babeli/* Jan De Leeuë	Klubi i debatit Klubi i leximit	Nëntor
4	*E bardha dhe e zeza*/ Malorie Blackman	Konkursi i eseve	Dhjetor
5	*Gjenerali i Ushtrisë së vdekur*/ Ismail Kadare	Klubi i leximit Klubi i filmit Laboratori i informatikës Biblioteka	Janar
6	*Kronikë në gur*/ Ismail Kadare	Klubi i debatit Klubi artistik	Shkurt
7	*Tre sprova mbi letërsinë botërore: Eskil, Dante, Shakespeare*/ Ismail Kadare	Klubi i leximit Klubi i filmit Klubi i debatit Klubi krijues	Mars
8	*Princi i Vogël*/Antoine de Saint Exupery	Klubi artistik Klubi i leximit	Prill
9	*Gjuetari i balonave*/ Khaled Hosseini *Fundamentalist padashje*/ Mohsin Hamid *Alkimisti*/ Paolo Coelho *Pa zemër në kraharor*/ Mira Meksi	Klubi i leximit Klubi i filmit Klubi i debatit Klubi krijues	Maj
10	*Shfaqje edukative përmbyllëse*	Klubi i leximit Klubi i filmit Klubi i debatit Klubi krijues Klubi i teatrit	Qershor

METODOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARIVE

VEPRIMTARI I

Klubi i leximit; Klubi i debatit; Mediumi elektronik (risia: diskutim në chat)

***Çunat nuk qajnë*, Malorie Blackman**

Veprimtaria **(aktivizimi i kompetencave)**	"Çunat nuk qajnë" i shndërruar në një grup chat-i. Kompetencat që aktivizohen gjatë këtij aktiviteti: 1. Kompetenca e të menduarit kritik dhe krijues; 2. Kompetenca e të shprehurit dhe komunikimit; 3. Kompetencat në teknologji; 4. Kompetenca digjitale; 5. Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare.
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Klubi i leximit
Zbatues / pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20) Mësues i letërsisë Mësues i TIK Psikologë Prindër
Qëllimi	Të ndërtohen premisat për të kuptuar përmes letërsisë - si duhet të përballet një adoleshent me të papriturat e jetës, - si duhet të mësojë të japë dashuri e të mosparagjykojë, - si të ndërtojë të menduarit kritik, përtej klisheve dhe paragjykimeve, qofshin këto paragjykime të shoqërisë, qofshin të familjes.
Objekti konkret	"Çunat nuk qajnë" është libri konkret, i cili, i përpunuar si një bashkëbisedim nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja mund t'i përcjellë mesazhet e mirëkuptimit, tolerancës dhe shembjes së paragjykimeve në marrëdhëniet e të rinjve me familjen dhe shoqërinë.
	Rikrijim në formatin digjital Nxënësit ndahen në disa grupe që do të ndërtojnë një dialog përmes chat-it, para se të lexojnë librin. Chat-i do të ndërtohet në formë temash të hedhura për diskutim nga mësuesja duke u nisur nga tre ngjarjet që qëndrojnë në qendër të romanit: 1. një shtatëmbëdhjetë vjeçar që, ndërsa pret përgjigjet e provimeve të pranimit në universitet, e gjen veten baba të një vajze disa muajshe, për të cilën nuk kishte dijeni

Metoda/ mënyra e realizimit	2. vëllai që zbulon një identitet të ndryshëm të të vëllait të vogël, i cili edhe vetë e kupton dhe e pranon të qenit homoseksual; 3. një baba që vihet përballë këtyre dy ngjarjeve në jetën e dy djemve të tij. Këto tre ngjarje të romanit, mund të shdërrohen nga mësuesja në këto pyetje që hidhen në grupin e chat-it të klasës: 1. Si do të reagonit nëse do të merrnit vesh që një shoqja/shoku juaj është bërë mama/baba ndërkohë që është ende në shkollë të mesme? 2. A do ta pranonit në shoqëri si më parë? 3. Si mendoni se do të silleshin mësuesit ndaj një nxënësi që ndodhet para kësaj të papriture? 4. Si mendoni se do të reagonin prindërit tuaj nëse do të përballeshin me faktin që ju po përgatiteni të bëheni prindër për shkak të një marrëdhënieje kalimtare që tashmë ka mbaruar? 5. A do t'ju mbështesnin nëse ju do të zgjidhnit të mbanit të gjitha përgjegjësitë për ta rrijur fëmijën, qoftë edhe të vetëm? 6. A do të reagonin ndryshe prindërit nëse do të ishit vajzë apo djalë? 7. A do ta shihnit me tjetër sy një shoqe/shok nëse ai do t'ju rrëfente se prirjet e tij seksuale janë LGTB? 8. A do ta ruanit shoqërinë me të nëse e gjithë shoqëria do ta njihte tashmë prirjen e tij seksuale? 9. A do të ndërhynit nëse një njeri juaj i afërt, ose shoqe/shok dhunohet nga persona homofobë për hir të prirjeve të tij seksuale? 10. Si mendoni se do të reagonin përgjithësisht prindërit shqiptarë nëse do të përballeshin me prirje seksuale LGTB? Pasi të gjithë nxënësit të organizuar në këto grupe chat-i t'i kenë dhënë përgjigje pyetjeve të shtruara nga ju gjatë dy javëve, u jepet për t'u lexuar libri "Çunat nuk qajnë".

	Zhvillim 2: **Klubi i leximit** - Rimerr bisedën **për të krahasuar** përgjigjet e pyetjeve të tyre para leximit të librit me përgjigjet pasi janë njohur me ngjarjet dhe zgjedhjet e personazheve të librit. - **Përballet dhe vlerëson** ngjarjet dhe zgjedhjet e personazheve dhe të nxënësve përmes një bashkëbisedimi ku ftohen të marrin pjesë edhe prindërit edhe psikologu.
Rezultatat e pritshme	- Të ndihmojë nxënësit të zbulojnë identitetin e vet personal e ta pranojnë atë me dinjitet, pavarësisht vështirësive të pranimit nga shoqëria; - të hetojnë të ngjashmin e të ndryshmin duke i respektuar ata si të barabartë me të; - të vlerësojnë faktin se të qenit të ndryshëm është pasuri e njerëzve; - të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre në shoqëri.
Koha e realizimit	Muaji shtator

VEPRIMTARI II
Klubi i debatit
Unë jam Malala, Malala Yousafzai

Veprimtaria	Zhvillimi i kompetencave themelore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare

(aktivizimi i kompetencave)	3. Kompetenca e shfaqjes së identitetit kulturor, mirëkuptimit e larmisë së kulturave, krijimi dhe paraqitja e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Klubi i debatit
Zbatues / pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20) Mësues Psikologë Prindër Përfaqësuesit fetar përmes videomesazhit
Qëllimi	- Të ndërtohen premisat për të kuptuar përmes letërsisë se çdo të thotë tolerancë, mirëkuptim, - Si mund ta luftojmë ekstremizmin e dhunshëm përmes modeleve të jetës që krijon e pasqyron letërsia.
Objekti konkret	"Unë jam Malala" është libri konkret që do të vihet në qendër të debatit. Si ndikon identiteti kulturor dhe larmia e kulturave për të vendosur urat e bashkëpunimit, tolerancën dhe mirëkuptimin mes individëve që i përkasin kulturave, besimeve të ndryshme.
Metoda/ mënyra e realizimit	**Debat tematik** përmes **krahasimit** të këndvështrimeve të pjesëmarrësve duke u bazuar në këto piketa të librit. Pasi ta kenë lexuar librin: 1. Një nxënëse mban para bashkëmoshatarëve fjalimin që Malala ka mbajtur para Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e vajzave për t'u arsimuar (Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit). 2. Nxënësit do të ftohen të hetojnë dy këndvështrimet e ndryshme që ekzistojnë në libër: - E drejta e vajzave për t'u shkolluar, përfaqësuar në libër nga zëri i Malalës dhe i familjes së saj. - Kundërshtimi i pjesëtarëve të një grupi ekstremist ndaj kësaj të drejte. Nxënësit do të debatojnë mbi këto dy këndvështrime. Nxënësit do të nxiten të hetojnë ndryshimin mes dy vendeve, si dy situata e emocione të ndryshme, pozitive e negative: a) vendlindjes së Malalës, qoftë kjo si parajsa e fëmijërisë e rrethuar me dashurinë e familjes, qoftë si vendi ku dikush me të cilin ndan të njëjtën kombësi e në dukje të njëjtën fe, i ka dhënë vetes të drejtën t'i marrë jetën; b) vendit ku Malala shkon për t'u shëruar, ku gjendet në fillim e vetmuar dhe e tëhuajsuar.

	Në këtë pikë debati duhet drejtuar **te diferenca** mes identiteteve të ndryshme kulturore (në libër mes Pakistanit dhe Britanisë, mbështetur në pjesë të librit që duhen lexuar e përdorur si argument për këtë ndryshim) duke i krahasuar ato edhe me përvojat personale të nxënësve (raste emigrimi, kontaki me moshatarë të kombësive e besimeve të ndryshme) duke theksuar larminë e kulturave si pasuri. 1. Nxënësit ftohen të hetojnë shkrimin autobiografik të Malalës, pra historinë e jetës së saj dhe ndër të tjera të dialogojnë mbi barazinë mes vajzave dhe djemve duke u nisur nga: a) përvoja personale e tyre në shkollë e në shoqëri - si reagoni ndaj bashkëmoshatarëve që i përkasin një besimi fetar tjetër; - si reagoni ndaj mbajtjes së simboleve që e përcaktojnë që në pamje përkatësinë në një mesim fetar; - a mundoheni t'i integroni në grupin tuaj bashkëmoshatarët që i përkasin një besimi tjetër fetar me tuajin; b) nga përvojat në familje - si reagojnë në familjen tuaj kur ndeshin me bashkëmoshatarë apo shokë tuajt që mbajnë simbole të dukshme të përkatësisë në një besim fetar (varëse, veshje etj). - sa është i ngjashëm apo i ndryshëm reagimi juaj me atë të prindërve tuaj (sipas rasteve konkrete që mund të jenë krijuar nga biseda në familje); c) nga libra të tjerë që trajtojnë të njëjtën temë (nga librat që kanë trajtuar në programin shkollor ose jashtë këtij programi). 2. Nxënësit drejtohen të analizojnë temën e të drejtave të njeriut si një fushë ku asgjë nuk është arritur thjeshtë, por për të cilat është luftuar e luftohet përditë në historinë e njerëzimit. 3. Nxënësit nxiten të përdorin njohuritë nga lëndët e tjera (histori, sociologji, filozofi etj) për të sjellë informacione mbi mënyrën si është luftuar për të drejtën e shprehjes, të votës, arsimit, të besimit etj në vende e në periudha të ndryshme.
Rezultatat e pritshme	- të zbulojnë identitetin e vet personal e kulturor, - të hetojnë të ngjashmin e të ndryshmin duke i respektuar ata si të barabartë me të; - të vlerësojnë faktin se të qenit të ndryshëm është pasuri e njerëzve; - të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre në shoqëri.

Koha e realizimit	Muaji tetor

VEPRIMTARI III
Klubi i debatit; klubi i leximit
Babeli, Jan De Leeuw

Veprimtaria (aktivizimi i kompetencave)	Zhvillimi i kompetencave themelore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare 3. Kompetenca e shfaqjes së identitetit kulturor, mirëkuptimit e larmisë së kulturave, krijimi dhe paraqitja e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme 4. Kompetenca e të menduarit kritik
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Klubi i debatit, klubi i leximit
Zbatues / pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20) Mësues Psikologë Përfaqësuesit fetarë
Qëllimi	- Të ndërtohen premisat për të kuptuar përmes letërsisë çdo të thotë miqësi, tolerancë, mirëkuptim; - Si mund ta luftojmë ekstremizmin e dhunshëm e premisat e terrorizmit e radikalizmit përmes modeleve të jetës që krijon e pasqyron letërsia; - Miqësia dhe dashuria si kundërpërgjigje ndaj urrejtjes, ndasive dhe terrorizmit.
Objekti konkret	**Kujt t'i besosh në një botë ku prevalon ligji i më të fortit?** "Babeli" është libri konkret që do të vihet në qendër të debatit duke u mbështetur në këndvështrimet apo "leximet" individuale të nxënësve mbi këtë libër. Tema e takimit të klubit të debatit "Terrorizmi dhe paraja *versus* miqësisë dhe dashurisë".
	Në këtë debat, nxënësit do të orientohen t'i japin argumentat e tyre mbi temat e propozuara në platformën shoqëruese të

Metoda/ mënyra e realizimit	aktivitetit, duke u mbështetur në mesazhet, personazhet dhe ngjarjet e romanit "Babeli". Debati mund të zhvillohet në dy faza: **Faza e parë:** nxënësit ndahen në grupe që përfaqësojnë mendimet dhe këndvështrimet e personazheve të romanit mbi këto tema të debatit që përfaqësohen në libër nga këndvështrimet e personazheve: 1. ideja e parasë, vlera e saj në jetë, pushteti i parasë dhe pushteti mbi veten; 2. ideja e miqësisë dhe vlera e saj në jetë në kundërpeshë me vlerën e parasë dhe me atë të urrejtjes ndaj të ndryshmit; 3. ideja e besimit dhe bestytnisë dhe pasojat e tyre në jetën e individëve dhe të shoqërisë; 4. ideja e hakmarrjes ndaj padrejtësive, mënyrat dhe pasojat e hakmarrjes në jetën e individëve; 5. ideja e terrorizmit si padrejtësi ndaj të pafajshmëve dhe si dhunë ndaj atyre që konsiderohen armiq prej një besimi të verbër. **Grupet që përfaqësojnë këndvështrimet e personazheve:** - Grupi që përfaqëson këndvështrimin e Naomit. - Grupi që përfaqëson këndvështrimin e Alisa Babelit (duke pasur parasysh edhe fundin e romanit) - Grupi që përfaqëson këndvështrimin e Abraham Babelit - Grupi që përfaqëson këndvështrimin e Lihtenshternit - Grupe të tjera. **Faza e dytë** Pasi të jetë kryer faza e parë dhe të gjithë pjesëmarësit në debatin e hapur, edhe të ftuarit nga komuniteti i mësuesve, prindërve, përfaqësuesve të komuniteteve fetare, psikologëve etj. të jenë njohur me këndvështrimet e personazheve të librit të përfaqësuara nga grupet e studentëve mbi temat e shtruara për debat, ftohen nxënës të tjerë, duke përfshirë ndoshta edhe vetë nxënësit e parë, që të paraqesin këndvështrimet e tyre personale të argumentuara mbi temat e shtruara në debat.
Rezultatat e pritshme	- Të ndihmojë nxënësit të zbulojnë identitetin e vet dhe vlerat më qenësore në jetën e njerëzve; - të hetojnë të ngjashmin e të ndryshmin duke i respektuar ata si të barabartë, ndonëse të ndryshëm; - të njohin e vlerësojnë shpirtëroren, sidomos miqësinë e dashurinë mes qënieve njerëzore si kundërvënie ndaj hakmarrjes; - të njohin e të vlerësojnë sakrificat njerëzore në emër të dashurisë dhe miqësisë; - të njohin e t'i japin vlerën e duhur materiales që jo gjithmonë e domosdoshmërisht të drejton për nga

	lumturia.
Koha e realizimit	Muaji nëntor

VEPRIMTARI IV
Konkursi i eseve
E bardha dhe e zeza, Malorie Backman

Veprimtaria (aktivizimi i kompetencave)	Zhvillimi i kompetencave themelore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare 3. Kompetenca e të menduarit kritik
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Konkurs me ese (në shkollë) Tema: "Sikur të isha unë"
Zbatues / pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20) Mësues Psikologë Prindër
Qëllimi	Të ndërtohen premisat për të kuptuar përmes letërsisë çdo të thotë racizëm, terrorizëm, ekstremizëm i dhunshëm përmes modeleve të jetës që krijon e pasqyron letërsia duke pasur në qendër personazhe të moshës rinore dhe një botë distopik.
Objekti konkret	"E bardha dhe e zeza" e Malorie Backman është libri konkret mbi të cilin do të ndërtohet konkursi i eseve në të cilin do të marrin pjesë nxënës të të gjitha viteve të shkollës së mesme.
Metoda/ mënyra e realizimit	*Konkursi i eseve mund të organizohet duke u mbështetur në detyrimin e programit për të hartuar esetë argumentuese dhe mund të lidhet me ato orë mësimore kur zhvillohet tema e esesë argumentuese.* Konkursi i eseve "Sikur të isha unë" do të shpallet në shkollë i bazuar mbi një platformë orientuese tematike që parakupton leximin dhe zbërthimin e librit "E bardha dhe e zeza" nisur nga këndvështrimi i vlerave të: - Tolerancës; - Mirëkuptimit; - Luftës kundër racizmit;

	- Gjithëpërfshirjes e bashkëpunimit; - Respektit të ndërsjelltë mes të ndryshmëve dhe të barabartëve; - Parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm e terrorizmit. **Platforma e konkursit do të bazohet mbi këto koncepte që mbart libri:** 1. Një shpjegim të konceptit të **racizmit** pikërisht në këtë libër distopik ku është krijuar një botë fiksionale e shkruar në të përkundërt me botën reale: Krosët (popullsia me ngjyrë) janë sunduesit dhe qerosët (të bardhët) janë të shtypurit e të nënshtruarit. Gjithsesi, shtypja dhe dhuna racore mbetet po ajo, pavarësisht se duket sikur janë ndërruar vendet. 2. Një nga mundësitë për ta bërë më të dukshëm këtë "distopi" të Malorie Backman në trajtimin e eseve të nxënësve është edhe **krahasimi** me një libër tjetër letrar të programit shkollor (p.sh. "I huaji" i Kamysë), ose me një libër jashtë programit shkollor "Racizmi shpjeguar vajzës sime" nga Tahar Ben Jelloun, ose me ndonjë film (p.sh. "Time to kill" prej të cilit mund t'u rekomandohet nxënësve të nxiten sidomos nga fjalimi i fundit i avokatit mbrojtës të një babai me ngjyrë që akuzohet për vrasjen e dy përdhunuesve të vajzës së vet të mitur). 3. Një shpjegim të koncepteve **extremizëm i dhunshëm** dhe **terrorizëm** duke u nisur nga reagimi i personazhit gjashtëmbëdhjetëvjeçar Kallumit, i cili pasi ka mbrojtur për një kohë të gjatë atë në të cilën beson, dashurinë dhe mirëkuptimin mes njerëzve pavarësisht ngjyrës së lëkurës dhe prejardhjes sociale, detyrohet nga konvencionet sociale të përfundojë në ekstremizëm dhe në terrorizëm. 4. Një nxitje më tepër për nxënësit e përfshirë në këtë konkurs esesh për çështjen e **diferencave dhe barazisë**, paragjykimeve dhe stereotipeve sociale mund të hetohet përmes krahasimit të librit "E bardha dhe e zeza" dhe "Fundamentalist pa dashje". 5. Një tërheqje vëmendeje e nxënësve të përfshirë në konkursin e eseve tek **vlera universale e dashurisë**, në rastin konkret ajo mes dy të rinjve, Kallumit dhe Stefit, e cila ndërton gjithnjë ura komunikimi edhe atëherë kur duket më e vështirë dhe më e pamundur se kurrë. 6. Si nxitje mund të shërbejë krahasimi i përfundimit të romanit "E bardha dhe e zeza" me tragjedinë "Romeo e Xhulieta" të Shekspirit. Dashuria dhe jo dhuna është përgjigja më e mirë ndaj racizmit (siç lihet e hapur në

	fundin e romanit me lindjen e fëmijës së Kallunit dhe Stefit, i një jete të re që triumfon ndaj dhunës, urrejtjes e vdekjes).
Rezultatat e pritshme	- Të ndihmojë nxënësit të zbulojnë identitetin e vet personal e kulturor, - të hetojnë të ngjashmin e të ndryshmin duke i respektuar ata si të barabartë me të; - të vlerësojnë faktin se të qenit të ndryshëm është pasuri e njerëzve; - të njohin përgjigjet bazuar në vlerat njerëzore e demokratike ndaj racizmit, extremizmit dhe terrorizmit.
Koha e realizimit	Muaji dhjetor

VEPRIMTARI V

Klubi i leximit; Klubi i filmit; Laboratori i informatikës; Biblioteka e shkollës

***Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Ismail Kadare**

Veprimtaria **(aktivizimi i kompetencave)**	1. Kompetenca shprehëse dhe e komunikimit 2. Kompetenca digjitale. 3. Kompetenca për të nxënë gjatë gjithë jetës. 4.Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare. 5.Sipërmarrja, aftësia për të shndërruar idetë në veprime. 6.Shfaqja e identitetit kulturor, mirëkuptimi i larmisë së kulturave, krijimi dhe paraqitja e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme 7. Kompetenca e të menduarit kritik dhe krijues
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Eskursion "virtual" nëpër qytetetet ku zhvillohen ngjarjet e "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur". Klubi i leximit; Laboratori i informatikës; Biblioteka e shkollës
Ekzekutues / pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20) Mësues letërsie, Mësues historie Mësues gjeografie Prindër
Qëllimi	**Guidë letrare** "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" - Të njohim vendin tonë dhe vetveten, përmes këndvështrimit të të tjerëve për ne. - Të njohim tjetrin, të huajin, pushtuesin, të mundurin përmes tolerancës e mirëkuptimit.

	- Të zbulojmë dallimet kulturore dhe të përbashkëtat njerëzore. - Një dialog me të shkuarën për të mos e përsëritur në të ardhmen: historia si mësuese e të ardhmes.
Objekti konkret	Krijimi i një itinerari letrar: Në gjurmët e "Gjeneralit të ushtrisë së vdekur".
Metoda/ mënyra e realizimit	Itinerari i rrugës që bën gjenerali me priftin për të gjetur eshtrat e ushtarëve italianë do të përfshijë: a. zbulimi në tekst i qyteteve ku zhvillohen ngjarjet në roman b. ndërtimi i një harte "letrare" digjitale me piketat e vendeve ku zhvillohen ngjarjet; c. "mbushja" e kësaj harte me pjesë nga përshkrimet e romanit. d. krijimi i një antologjie digjitale me pjesët ku shfaqet këndvështrimi i gjeneralit për shqiptarët. e. krijimi i një antologjie digjitale me pjesët ku shfaqet këndvështrimi i shqiptarëve për gjeneralin, për italianët, për pushtuesit e të huajt në përgjithësi. **Krijimi i një faqeje web ku të gjithë të përfshihen:** - elementet e itinerarit letrar (përmes një google map) me piketa. P.sh., ku zhvillohet dasma - pjesët antologjike nga teksti në vendet ku zhvillohen në hartën digjitale - krijim i videove me interpretime të monologëve apo pjesëve të veçanta të romanit që mund të vendosen në itinerar. P.sh. Monologu i gjeneralit, monologu i plakës Nicë etj. - pjesë nga filmat e ndryshëm që janë bërë mbi veprën. (përpiquni të zgjidhni të njëjtët elementë të romanit duke i krahasuar ato me pjesët e filmave, të krijuar nga regjizorë shqiparë dhe nga regjizorët e huaj duke u përqendruar edhe në ndryshimin e këndvështrimeve mes tyre). **Një blog:** - një ditë në Tiranën e Kadaresë me *Gjeneralin e ushtrisë së vdekur*, - video me xhirime duke lexuar pjesë nga romani në Tiranë. - një antologji audio me pjesë nga libri (p.sh. mendimet e gjeneralit) që mund të dëgjohen ndërsa një grup nxënësish bëjnë të njejtën rrugë që bën gjenerali për të shkuar, p.sh. nga hotel *Dajti* në Tiranë deri në...) **Ndërtimi i një këndi ndërveprues** në faqen ëeb midis dy

	grupeve të nxënësve të përfshirë: a. nxënësit që do të gjejnë pjesët nga *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* ku përshkruhet Shqipëria dhe shqiptarët. b. nxënësit që do të gjejnë pjesët prej veprave të tjera të letërsisë shqipe dhe botërore ku përshkruhet Shqipëria dhe shqiptarët (p.sh. "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit" nga Faik Konica; "Udhëtimi i Çajld Haroldit, Bajron; etj) c. Pjesë nga këngët që këndohen në dasëm (këngët polifonike)
Rezultatat e pritshme	- Të ndihmojë nxënësit të zbulojnë identitetin e vet kombëtar personal e kulturor në përballje me këndvështrimet e "të tjerëve"; - të hetojnë të ngjashmin e të ndryshmin duke u përpjekur të dialogojnë me të ndryshmin në emër të vlerave të jetës - të krijohen ura lidhëse mes kohëve, vendeve dhe shkrimeve; - të mësojë që dhuna e luftës të sjell vetëm pasoja negative dhe toleranca e bashkëjetesa janë vlera për të cilat ia vlen të punosh në emër të jetës; - të mësosh të mendosh në mënyrë kritike, përtej shablloneve - të mësohet që të mendohet në mënyrë krijuese.
Koha e realizimit	Muaji janar (me rastin e 85 vjetorit të lindjes së Ismail Kadaresë)

VEPRIMTARIA VI
Klubi i debatit, Klubi artistik

***Kronikë në gur*, Ismail Kadare**

Veprimtaria Aktivizmi i kompetencave	1. Kompetenca shprehëse dhe e komunikimit 2. Kompetenca digjitale. 3. Shfaqjen e identitetit kulturor, mirëkuptimin e larmisë së kulturave, krijimin dhe paraqitjen e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme 4. Kompetenca e të menduarit kritik
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Klubi i debatit Klubi artistik
Zbatues/pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20) Mësues Psikologë

Qëllimi	Përmes kësaj vepre nxënësit duhet: - Të njihen me një dimension më të afërt me shkrimtarin - Të kuptojnë veprën përmes kujtimeve të fiksionalizuara - Të kuptojnë përthyerjen letrare të historisë - Të promovojnë vlerat e qëndrueshme njerëzore
Objekt konkret	*Kronikë në gur*, të shihet si një libër artistik i cili meriton vëmendje për diskutime të ndryshme, por sidomos në: - optikën e ndikimit të vendit, shijes, njerëzve në formimin dhe të ardhmen e një njeriu - promovimin e vlerave të lokalitetit si pjesë e identitetit shpirtëror dhe kulturor
Mënyra /metoda e realizimit	Modaliteti zhvillues i këtij aktiviteti kërkon disa angazhime si p.sh.: 1. **Tour eksplorues** në: - shtëpinë e lindjes së shkrimtarit në Gjirokastër - shtëpinë-muze të shkrimtarit, Tiranë 2. **Klubi i debatit** për t'i dhënë përgjigje pyetjeve si: - Sa ndikon fëmijëria te njeriu/shkrimtar? - A i përzgjedhim kujtimet e fëmijërisë apo ato më të fortat nuk zhbëhen kurrë, na shoqërojnë tërë jetën? - A rritet dikur fëmija, apo për vendin e lindjes rri i pandryshuar edhe kur fëmija nuk është më aty? - Sa dhe si mbahen lidhjet shpirtërore, si i përcaktojmë ato - A jemi në gjendje të ndajmë vlerat që duhet të na udhëheqin nga zakonet që i kemi mes nesh? 3. **Grupi artistik** mund të ideojë rikrijime me sendet personale apo zbulime të rutinave që do të mësojë gjatë vizitave
Rezultatet e pritshme	Në këtë lloj aktiviteti nxënësit pritet të: - Mësojnë të njohin veten - Të kuptojnë përkatësitë personale - Të vlerësojnë lidhjet shpirtërore - Të identifikojnë vlerat lokale - Të respektojnë historinë etj
Koha e realizimit	Muaji Shkurt

VEPRIMTARI VII

Klubi i dramës, klubi i filmit, klubi i debatit, Klubi artistik dhe TIK, konkursi i eseve

***Tre sprova mbi letërsinë botërore: Eskil, Dante, Shakespeare*, Ismail Kadare**

Veprimtaria **Aktivizimi i kompetencave**	**Zhvillimi i kompetencave themelore:** 1. kompetenca e të menduarit kritik 2. kompetenca e të menduarit krijues **3.** kompetenca ndërpersonale, qytetare, shoqërore, ndërkulturore
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Klubi i debatit Klubi i dramës Konkursi i eseve tematike Klubi artistik dhe TIK Klubi i filmit
Zbatues / pjesëmarrës	Nxënës (rreth 30) Mësues të artit, të letërsisë Psikologë Prindër
Qëllimi	Tre sprovat në një aktivitet kanë si qëllim përqendrimin në: - **krahasimin dhe përballjen e kulturave të ndryshme** që trajtojnë fenomene të njëjta edhe pse me largësi gjeografike e diferenca kohore - **autorët dhe sfidat e botimeve të tyre** (humbjet, diktaturat) Përse Eskili, Dantja dhe Shekspiri? - Sepse te të tre këta autorë, Kadare do të vlerësojë elementët universalë njëkohësisht edhe impaktin ndërkulturor botëror. - Sepse janë referenca të kulturës dhe mendimit gjenial botëror.
Objekti konkret	Tre sprovat duhet të testojnë **të menduarit kritik** mbi: - motivet dhe idetë e ngjashme te të tre autorët - krahasimin e tyre me kontekstin shqiptar (politik, autorial, kanunin, etj.) - modelimin e letërsisë botërore në ndikimin e këtyre autorëve. Te Eskili: *çdo shkelje e së drejtës kërkon shpagimin e saj*. Ankthi i Eskilit për të ruajtur fytyrën e njerëzimit si mesazh i veprës së tij. Te Dantja simbolika e ndëshkimit. Simbolikë që të sugjeron gjendjen natyrale të shkrimtarit të madh i cili dyzohet në një proces udhëtimi: të udhëtojë i gjallë midis vdekjes, të jetë mes dritës dhe errësirës.

	Te Shekspiri të hetohet karakteri universal i Hamletit dhe arsyetimi të shtrihet te ndryshimi me gjaksit e Shqipërisë së Veriut (hakmarrja/gjakmarrja)
Metoda/mënyra e realizmit	Modaliteti zhvillues për të tre sprovat është: 1. **Konkursi i eseve** krahasimore me temat e sugjeruara: - Gjakmarrja dhe vetëgjyqësia **(**Orestia/Kanuni shqiptar) - Rrëmbimi; flijimi; kodet e vrasjeve, riti i varrimit; i nderimit etj. 2. **Klubi i debatit** Debate mbi çështjet: - Hakmarrja - Vetëgjyqësia - Falja - Ndëshkimi etj. **3. Krahasimi i vlerave të veprave të autorëve me shembuj që trajtojnë të njëjtat motive në tekstet letrare (fantazma, mbajtja e premtimit, vrasja, kodet)** - Eskili pa 'etër' letrarë, por At i tragjedisë (vdekja dhe lavdia e saj) - Dantja, krijuesi i 'rrathëve' të dënimit dhe 'lumturimit' - Shekspiri, gjakmarrjet dhe hakmarrjet **4. Dramatizime** Nxënësit mund të performojnë dramatizime nga veprat e këtyre autorëve. Mund të luajnë pjesë të veçanta e të përzgjedhura 5. **Klubi i filmit** Mund të krijohet një video-kolazh me përmbledhje të inskenimeve teatrale dhe kinematografike të veprave të këtyre autorëve 6. **Klubi artistik dhe TIK** Nxënësit e angazhuar pranë këtij klubi mund të marrin përsipër krijimin e një filmi të animuar, i cili përmes fotove apo pikturave të larmishme të njëpasnjëshme të realizojë vizualisht nën një bazë muzikore zbritjen në rrathët e ferrit duke përdorur aplikacione si: stop motion studio, playmobil etj **7. Klubi artistik (piktura)** Nxënësit mund të kthejnë perceptimin e personazheve tipikë të autorëve në imazhe, piktura… *Prometheu, personazhe të caktuar të rrathëve të ferrit, Hamleti në dilemë etj…*
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të eseve reflektuese, vlerësuese, kritike, realizimeve artistike dhe performancave teatrore mbi veprat e tre shkrimtarëve të mëdhenj botërorë me të cilët lidhen ndryshimet më të mëdha të modeleve letrare pas tyre, nxënësit duhet: - të kuptojnë rëndësinë e përfaqësimit të secilit në letërsinë botërore - të dallojnë afritë dhe largësitë mes kulturave

	- të pranojnë diversitetin dhe po aq të vlerësojnë identitetin - të perceptojnë artistikisht veprat dhe personazhet e njohura - të rikrijojnë mbi temat, motivet dhe simbolikat e personazheve - të vlerësojnë dhe të ndiejnë përgjegjësinë e veprimeve dhe motivimeve të akteve njerëzore
Koha e realizimit	Muaji Mars

VEPRIMTARI VIII Klubi i artit; Klubi i leximit *Princi i vogël,* **Antoine de Saint-Exupéry**	
Veprimtaria **(aktivizimi i kompetencave)**	Zhvillimi i kompetencave themelore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit kritik 3. Kompetenca e të menduarit krijues 4. Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare 5. Kompetenca e shfaqjes së identitetit kulturor, mirëkuptimit e larmisë së kulturave, krijimi dhe paraqitja e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme 6. Kompetenca e të shprehurit përmes arteve
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Klubi i leximit, klubi i arteve
Zbatues / pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20) Mësues të artit, të letërsisë Psikologë Prindër
Qëllimi	- Të ndërtohen premisat për të kuptuar përmes letërsisë se çdo të thotë tolerancë, mirëkuptim - si mund të luftojmë për të njohur vetveten duke krijuar marrëdhënie me të tjerët, të ngjashmit e të ndryshmit tanë, pa hequr kurrë dorë nga ëndrrat - Si e njohim veten përmes përmasës së krijimit dhe rikrijimit?
Objekti konkret	**Ekspozitë e arteve të aplikuara: "A është kjo një kapele?"** Ekspozitë e arteve të aplikuara me temë "A është kjo një kapele" frymëzuar nga libri "Princi i vogël" i Antoine de Saint-Exupéry.
Metoda/ mënyra e realizimit	**Ekspozita e arteve të aplikuara** do të priret t'i frymëzojë nxënësit që, pas leximit të "Princit të vogël" të shprehen përmes arteve të tjera: - Pikturë - Video kolazhe - Performanca audio-vizive Pra: "leximet" e tyre krijuese mbi këtë libër. Në ndihmë të tyre do të përgatitet një platformë mbi mënyrat e ndryshme të leximit krijues të "Princit të vogël" duke pasur parasysh këto tema bosht të shtjelluara sipas modeleve të arteve vizive, audiovizive (të aplikuara) etj. Pasi ta kenë lexuar librin, nxënësit do të nxiten të reflektojnë në mënyrë krijuese për këto tema bosht duke u nisur nga personazhe dhe episode e librit: **Rëndësia e marrëdhënieve ndërpersonale**: simbolizohet në

	libër përmes marrëdhënies së princit me dhelprën. Në të, nuk kuptohet vetëm marrëdhënia mes të rriturit dhe fëmijës (piloti dhe princi i vogël), por edhe ajo mes të barabartëve (dhelpra, trëndafili etj). Në këtë pikë, ajo që dallon një njeri nga një tjetër është marrëdhënia që ndërtojmë me tjetrin duke shpenzuar kohë e emocione për ta njohur, si pikat e tij të dobëta, ashtu edhe pikat e forta të karakterit të tij. **Miqësia –** Secilit prej nesh i duhet të mendojë për dikë që na bën të ndjehemi të rëndësishëm, të ndjehemi se mendohemi prej dikujt, sepse ne nuk jemi një ishull, ekzistojmë në marrëdhënie me të tjerët. Duke e pranuar këtë realitet e duke mos notuar kundër natyrës sonë mund të jemi më në fund të lirë. **Zbulimi i identitetit, i brishtësive, frikërave dhe i të metave tona.** Një nga personazhet e librit, pijaneci që pi pikërisht pse ndjehet i turpëruar ngaqë pi, është përfaqësuesi më i mirë i rrethit vicioz në të cilin ndjehemi për hir të brishtësive tona, të cilat përpiqemi t'i maskojmë, në vend që t'i pranojmë dhe të mësojmë t'i përballim. **Ndarja dhe rritja:** Vaniteti dhe mburrja e trëndafilit te "Princi i vogël" bëhet shkaku i prishjes së tij me princin, i cili vuan pasi bashkë me trëndafilin humbet edhe pikën e tij të referimit. Por pikërisht kjo vuajtje, kjo ndjesi vetmie e cila e ngërthen Princin e vogël e çon atë në kërkim të planetëve të rinj, metaforë e faktit që prishja e një marrëdhënie është dy faqëshe: edhe humbje, por edhe mundësi e re njohjeje, të dyja njësoj reale. Me t'u përballur me humbjen, mund të shkojmë drejt kërkimit të mundësive të reja të njohjes, duke njohur së pari vetveten dhe vlerat për të cilat ia vlen të luftosh. **Vlera e vërtetë e gjërave:** personazhi i biznesmenit në libër përfaqëson njeriun që donte t'i kishte të gjithë yjet, po pastaj nuk dinte ç'të bënte me to. Dëshira për të pasur sa më shumë gjëra e njerëz në jetë ngaqë na bën të ndjehemi sikur kemi vlerë, por pa pasur vërtetë nevojë reale për to, duhet të na bëjë të reflektojmë për vlerën reale të gjithçkaje, sidomos të marrëdhënieve të cilat, që të lulëzojnë duhet të ushqehen, duan kohë dhe përkushtim. Në fund të fundit, shifra e "friends-ave" në facebook, instagram etj., a është vlera reale e jona, a na bën të ndjehemi me vlerë nëse është shifër e madhe, apo bëhet e pavlerë nëse nuk i përkushtohemi dhe nuk është "miqësi e vërtetë"? **Toleranca, njohja dhe pranimi i tjetrit –** Në librin "Princi i vogël" gjatë takimeve të tij me personazhet e ndryshme, mund të hetojmë se çdo person ka nevojë për praninë e të tjerëve që të përkufizojë vetveten. Ne ekzistojmë në marrëdhënie me të tjerët, psh., Gjeografi, nuk mund ta bëjë punën e vet pa eksploruesit, mburraveci nuk mund të jetë i tillë nëse nuk ka kujt t'i mburret, po ashtu edhe mbreti pa nënshtetasit e vet. Libri, duke u nisur

	pikërisht nga personazhet e tij mund të lexohet si një mesazh i tolerancës dhe pranimit të tjetrit, por sidomos si rizbulim i vlerës së ndjenjave dhe lidhjeve afektive. **Mos heqja dorë prej ëndrrave.** Piloti që ka mbetur në mes të shkretëtirës, në vogëli ka pasur një ëndërr, të bëhej piktor. Të rriturit ia shembën ëndrrën, sepse, nuk e kuptonin pikturën e tij (të gjithë të rriturve vizatim i tij i dukej **thjeshtë një kapele**, ndërsa në të vërtetë ishte një boa që ka gëlltitur një elefant). Kapelja e pilotit simbolizon në libër provën nëse ka mbetur ende ndonjë copëz fëmijë tek të rriturit që e shohin. Shprehja e nevojës për të mos i bjerrë ëndrrat e fëmijërisë gjithë jetën, kurajoja për të qenë të ndryshëm nga të tjerët dhe gjithsesi vetvetja, pa reshtur së "luftuari" me shoqërinë për t'u kuptuar prej saj është kërkesa themelore e kësaj ekspozite.
Rezultatat e pritshme	- Të ndihmojë nxënësit të zbulojnë identitetin e vet personal e kulturor, - të hetojnë të ngjashmin e të ndryshmin duke i respektuar ata si të barabartë me të; - të vlerësojnë faktin se të qenit të ndryshëm është pasuri e njerëzve; - të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre në shoqëri
Koha e realizimit	Muaji prill

VEPRIMTARI IX
Klubi i leximit, Klubi i filmit, Klubi i debatit, Klubi krijues
Udhëtim në kërkim të vetvetes

1. ***Gjuetari i balonave*, Khaled Hossein**
2. ***Pa zemër në kraharor*, Mira Meksi**
3. ***Fundamentalist pa dashje*, Mohsin Hamid**
4. ***Alkimisti*, Paolo Coelho**

(Njëri prej librave do të zgjidhet të jetë në qendër të njërit prej aktiviteve të klubeve të ndryshme, sipas këndvështrimit që ata zgjedhin; gjegjasi: klubi i leximit, i filmit, i debatit dhe klubi krijues.)

Veprimtaria (aktivizimi i kompetencave)	**Zhvillimi i kompetencave themelore:** 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; 2. Kompetenca e të menduarit kritik; 3. Kompetenca e të menduarit krijues; 4. Kompetenca ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare 5. Kompetenca e shfaqjes së identitetit kulturor, mirëkuptimit e larmisë së kulturave, krijimi dhe paraqitja e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme
Vendi/ njësia ku do të zhvillohet	Klubi i leximit Oborri i shkollës, Ekskursion në vendlindje Klubi i debatit Diskutim esesh
Zbatues/ pjesëmarrës	Nxënës (rreth 20 për çdo klub) Mësues Psikologë Prindër Përfaqësuesit fetarë
Qëllimi	- Të ndërtohen premisat për të kuptuar përmes letërsisë çdo të thotë tolerancë, mirëkuptim - si mund ta luftojmë ekstremizmin e dhunshëm përmes modeleve të jetës që krijon e pasqyron letërsia - si të luftojmë paragjykimet dhe stereotipet.
Objekti konkret	Ky set aktivitetesh me temë "Udhëtim në kërkim të vetvetes" mund të organizohet si një muaj i tërë leximi i organizuar nga klubi i leximit. Do t'u paraqiten nxënësve **katër libra**, në dukje shumë të ndryshëm mes tyre, por që përshkruhen nga i njëjti fill, **ai i udhëtimit si metaforë e kërkimit dhe zbulimit të vetvetes,** të ndjesive dhe njohjes së vetvetes duke kaluar nëpër marrëdhëniet me të tjerët dhe botën, mbushur me ngjarje, marrëveshje e mosmarrëveshje, tolerancë mirëkuptim e mospajtim. Katër librat janë: 1. *Gjuetari i balonave*

	2. *Fundamentalist pa dashje* 3. *Pa zemër në kraharor* 4. *Alkimisti*
Metoda/ mënyra e realizimit	Duke e trajtuar këtë udhëtim si një metaforë të zbulimit të vetvetes, të shpirtërores sonë sidomos në marrëdhënie me të tjerët, nxënësit do të nxiten të reflektojnë mbi këto këndvështrime të temës: - Vendlindja nga parajsa e fëmijërisë, zbulohet si vend i vuajtjes e tjetërsohet në sytë e të rriturit - Udhëtimi si zbulim i vetvetes, zbulimi i "Itakës" metaforike, i kthimit në vetvete si zbulim, vetëm pas një udhëtimi të gjatë largimi i kthimi. - Kahet e udhëtimit përcaktojnë edhe nevojat e kërkimit sipas rasteve
1. ***Gjuetari i balonave***	***Gjuetari i balonave*** – kthim në vendlindjen e shkatërruar nga dhuna dhe terrorizmi, si nevojë për të shlyer pengjet e një fëmijërie të pafajshme, por edhe e zbulimit të padrejtësive që mund të ndreqen nëse kthen kokën pas. Modaliteti zhvillues: - Realizimi i një **ekspozite** me foto-fakte nga biografia e autorit, foto nga filmi dhe pjesë nga libri. Kjo mund të ishte mënyra sesi reflektojmë mbi këtë "udhëtim" në fëmijërie. - Realizimi i një **videoje** ku të regjistrohen tre përvoja: a) Diskutimet e klubit të leximit mbi librin, b) Diskutimet e klubit të leximit mbi filmin "Gjuetari i balonave" c) Ritregimet e përvojave vetjake të nxënësve gjatë fëmijërisë
2. ***Fundamentalist pa dashje***	***Fundamentalist pa dashje*** – vendlindja e parë me sytë e një të huaji, klishetë, paragjykimet dhe stereotipitë, si mosnjohje dhe pengesa për njohjen e vërtetë dhe krijimin e marrëdhënieve mes të barabartëve dhe të ndryshmëve. Modaliteti zhvillues: - **Dramatizimi** i këtij libri, dhe loja e tyre me role, mund të ishte një mënyrë reflektimi dhe përdorim i kompetencës së të menduarit krijues.

3. ***Pa zemër në kraharor***	***Pa zemër në kraharor*** – zhvendosja në hapësirë, kohë e kultura të ndryshme, përmes një udhëtimi mistik në kërkim të shpirtërores që mund të zbulohet sidomos përmes artit. Modaliteti zhvillues: - **Ekspozitë digjitale** me pikturat e Frida Kahlo-s - **Krahasim** duke kombinuar pjesë nga përshkrimet e librit dhe të novelës "Aura" të Karlos Fuentes (të dy personazhe të librit "Pa zemër në kraharor", mund të ishte një mundësi realizimi reflektimit mbi vlerat e qenësishme në jetë, qoftë edhe duke i krahasuar me libra të tjerë nga programi shkollor i letërsisë - **Lexime vetjake** të nxënësve ku trajtohet tema e udhëtimit si zbulim i vetvetes dhe botës (p.sh. *Odisea, Uliksi, Udhëtimet e Guliverit*, etj.)
4. ***Alkimisti***	***Alkimisti*** Udhëtim i individit për të zbuluar botën në funksion të njohjes së vetes. Metafora e udhëtimit dhe e rikthimit. Është historia e djalit i cili mëson ta njohë veten dhe ta përmirësojë atë duke ndjekur ëndrrën. Me të mësohet si të mos humbësh shpresën por edhe si të ndjekësh udhëzimet e zemrës për të kapur Shpirtin e Botës në dimension krejtësisht personal e unik për t'u bërë pjesë e universales. Pastrimi i vazhdueshëm përfundimisht çon në përsosmëri. Ky nocion i njeriut, materies (kthimi i metalit në ar) dhe i të gjitha gjërave të tjera që ndajnë të njëjtin qëllim tregon se të gjithë elementët në natyrë janë në thelb forma të ndryshme të një fryme të vetme. Modaliteti zhvillues: - **Trajtimi eseistik** me tema specifike mbi shpresën, dëshirën, **legjendën personale** si mjeti i vetëm me të cilin një individ mund të jetojë një jetë të kënaqshme. Si Legjenda personale vjen si kërkesë *shpirtërore mbizotëruese* - mbase vetëm e shpirtit, pse qëndron ajo në qendër të teologjisë unike të Alkimistit? - **Diskutime:** *A rendet pas ëndrrave*? *Cilat janë ëndrrat e adoleshentëve sot?* *Si perceptohet materialja dhe shpirtërorja?* - **Rikrijim në poezi, apo tekst përshkrues e filozofik** si perceptohet nga nxënësit poetika e Shpirtit të Botës. - **Krahasim** me diskutimet për projektin e formatit kinematografik drejtuar nga Laurence Fishburne[30]

[30] https://en.wikipedia.org/wiki/Laurence_Fishburne

Rezultatet e pritshme	- Të ndihmojë nxënësit të zbulojnë identitetin e vet personal e kulturor, - të hetojnë të ngjashmin e të ndryshmin duke i respektuar ata si të barabartë me të; - të vlerësojnë faktin se të qenit të ndryshëm është pasuri e njerëzve; - të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre në shoqëri - të orientohen drejt vlerave themelore
Koha e realizimit	Muaji maj

VEPRIMTARI X
Klubi i leximit, Klubi i filmit, Klubi i debatit, Klubi krijues, Klubi i dramës
Shfaqje përmbyllëse

Veprimtaria **(aktivizimi i kompetencave)**	Zhvillimi i kompetencave themelore: 1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit 2. Kompetenca e të menduarit krijues 3. Kompetenca e shfaqjes së identitetit kulturor, mirëkuptimit e larmisë së kulturave, krijimi dhe paraqitja e ideve, e përvojave dhe e emocioneve në forma të larmishme 4. Kompetenca e të shprehurit përmes arteve
Njësia/ Vendi ku do të zhvillohet	Salla e aktiviteteve promovuese të shkollës
Zbatues/ pjesëmarrës	Nxënës (rreth 30-40) Mësues Psikologë Prindër Përfaqësuesit fetarë
Qëllimi	Të finalizohet një cikël veprimtarish i cili ka patur si qëllim edukimin e të rinjve përmes vlerave themelore si besimi, toleranca, respekti, paqja etj., përmes shfaqjes së një sërë reflektimesh që kanë ardhur si rezultat konkret i punës me librat artistikë të rekomanduar.
Objekti konkret	Ky do të jetë një aktivitet përmbyllës në formën e një shfaqeje artistike *e* cila do të përfshijë pjesët më të mira të marra nga të gjithë aktivitetet e parashikuara gjatë muajve të vitit shkollor. Në fokus do të jenë elementët më përfaqësues të çdo aktiviteti
Metoda/mënyra e realizimit	**Modaliteti zhvillues** I parë në kuadër të një aktiviteti ndërtuar vetëm përmes punës së vetë nxënësve ai mund të përfshijë disa rubrika: - një prezantim materiali filmik sensibilizues i përbërë për të gjitha temat e trajtuara nëpër libra përqendruar në kuotat më përfaqësuese së tyre (realizuar nga klubi i filmit dhe i teknologjisë). - një dramatizim me pjesët më përfaqësuese të ligjërimeve të personazheve (realizuar nga grupi i dramës). - një interpretim dinamik me exchange role play të pjesëve më interesante sipas përzgjedhjeve personale të nxënësve (realizuar nga klubi i leximit). - një kolazh fotografik apo piktura të frymëzuara nga këto vepra (realizuar nga klubi krijues). - një video prezantim për modelin e njeriut të së ardhmes (klubi i debatit). - një realizim spontan i një mesazhi të përbashkët në formë

	motivimi personal (përgatitur nga eseistët e rinj).
Rezultatet e pritshme	**Kjo veprimtari përmbyllëse te nxënësit duhet të:** - Krijojë mundësi për përzgjedhjen e të mësuarit në grupe me prirje të caktuara (të lexojnë, interpretojnë, filmojnë, debatojnë, shkruajnë, rikrijojnë etj.). - Krijojë ndjenjën e bashkëpunimit me sigurinë e gjithëpërfshirjes. - Nxisë krijimin dhe rikrijimin në formate të tjera artistike. - Krijojë bindjen se të mësuarit i aftëson ata në ato prirje me të cilat mund të punojnë më mirë në të ardhmen. - Zbulojë pjesën më të mirë të tyre, përmes promovimit të vlerave themelore që librat emetojnë.
Koha e realizimit	Muaji qershor

MONITORIMI

Monitorimi ka të bëjë me gjurmimin e nxënies së njohurive apo aftësive të ndryshme që gjenerojnë në këtë rast llojet e aktiviteteve edukuese. Natyra e vetë letërsisë kërkon reflektim aktiv (feedback) nga nxënësit përmes përgjigjeve reflektuese në pjesën më të madhe të rasteve, por edhe në drejtim të aftësimit të tyre për të zhvilluar pjesën krijuese.

Kontrolli i dijeve (learning probe) njohur ndryshe si sondazhi mësimor është një nga mënyrat efikase të monitorimit të këtyre aktiviteteve edukative që qendërsojnë vlerat themelore qytetare, përmes letërsisë fiksionale. Disa nga mënyra e zhvillimit të monitorimit të aktiviteteve renditen si më poshtë[31]:

Fazat e monitorimit	Mënyrat
Në fillim të aktivitetit	1. Thënie pikante nga libri për të tërhequr vëmendjen e nxënësve; 2. Klasifikimi i pyetjeve: 3. Pyetjet-zinxhir 4. Shtresëzimi i pyetjeve 5. Ndërveprimi 6. Ndërhyrja informative
Gjatë zhvillimit të aktivitetit	1. Bashkëshoqërimi 2. Ndalesat
Në fund të aktivitetit:	1. Përmbledhja (resumeja) verbale

Monitorimi i situatës në fillim të aktivitetit

1. **Thëniet hyrëse**: propozim për diskutim i thënieve me vlerë të veçantë që nxirren nga librat.
2. **Klasifikimi i pyetjeve**: nxënësit testohen përmes pyetjeve të shkurtra (po/jo).
3. **Pyetjet-zinxhir**: Krijimi i përgjigjeve-zinxhir për të njëjtën pyetje.
4. **Shtresëzimi i pyetjeve**: Përgatitja e pyetjeve më nivele vështirësie.
5. **Ndërveprimi:** Testimi i pyetjeve me përgjigjet pa përzgjedhje dhe përnqëndrimi për të bërë pjesë të diskutimit nxënësit e pa/ ose pak të aktivizuar.

[31] Worshan, Murray E. Austin. (1981). *Accountability for written work in junior high schools classe.*TX: Research and Development Center for Teacher Education

6. **Ndërhyrja informative**: Ndërfutja e informacioneve apo komenteve shtesë kur shterojnë përgjigjet e nënësve.

Monitorimi i situatës gjatë zhvillimit të aktivitetit

1. **Bashkëshoqërimi** dhe vëmendja e mësuesit gjatë gjithë kohës përmes kontaktit vizual
2. **Ndalesat:** mund të jetë e nevojshme ndonjë ndërprerje e aktivitetit nëse ka mbivendoshje emocionale nga ana e nxënësit ose për arsye të tjera. Kur ndodh kështu mësuesi duhet të sigurojë vijimin sipas një kodi shenjor miratimi të paracaktuar paraprakisht mes tyre

Monitorimi në fund të aktivitetit:

1. **Përmbledhja (resumeja) verbale**: nxënësit e kanë të nevojshme të marrin mendimin në fund të aktivitetit prej mësuesit të tyre. Kjo i ndihmon të dy palët për të kuptuar sesa efektiv ka qenë bashkëpunimi dhe sa janë realizuar objektivat.

PËRFUNDIME

Me anë të këtij udhëzuesi mësuesit do të ndihmohen:

- ✓ Të **organizojnë veprimtari edukative** në funksion të promovimit të vlerave themelore qytetare;
- ✓ Të **ndihmojnë** të rinjtë **në të kuptuarit** dhe përvetësimin e vlerave themelore që gjenerojnë nga veprat letrare përmes metodave të reja;
- ✓ Të **ndihmojnë në parandalimin** e shfaqjeve ekstremiste apo radikaliste mes të rinjve përmes veprimtarive edukative tematike;
- ✓ Të **përfshijnë nxënësit, prindërit dhe komunitetin** për zhvillimin e aktiviteteve edukative;
- ✓ Të **stimulojnë mendimin kritik dhe frymën e debatit** tek nxënësit mbi të kuptuarit e veprave letrare duke i përqasur personazhet apo situatat me krahasime dhe konkretizime;
- ✓ Të **sigurojnë gjithëpërfshirje**. Mësuesit të marrin përgjegjësi **për të siguruar** që të mësuarit në aktivitetet për nxënësit janë të drejtuara drejt arritjes së rezultateve të që priten prej veprimtarivet dhe angazhimit konkret të nxënësit, pra programit të individualizuar ku secili ka rolin e tij;
- ✓ Të **bashëkveprojnë**. Bashkëveprimi me nxënësit, qoftë ballë për ballë ose përmes teknologjisë, me çdo formë të mundshme, që shfaqet si modalitet për aktivitetet.
- ✓ Të **ideojnë dhe promovojnë** modele të reja për vijim të aktiviteteve në kohë pandemie.
- ✓ Të **mbështesin** përmes vlerave themelore që vijnë nga idetë e librave **aftësimin praktik** të nxënësve për të kuptuar çështjet ndërpersonale, të rëndësishme e delikate që prekin të gjithë komunitetin.

REFERENCA

Blackman, Malorie. (2019). *Çunat nuk qajnë*. Tiranë: Dituria.
Blackman, Malorie.(2018). *E bardha dhe e zeza*. Tiranë: Dituria.
Borum, Randy. (2011). "Radicalization into Violent Extremism I: A Review of Social Science Theories." *Journal of Strategic Security* 4, no. 4: 7-36.
Coelho, Paolo. (2003). *Alkimisti*. Tiranë: Toena.
Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, report, (2019). Bruksel. aksesuar në:
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf
Council of Europe Presidency, *Revised EU Strategy for Combating Radicalization and Recruitment to Terrorism* (2014)
Classification of learning activities (CLA) MANUAL. Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2016
Crossett C. & Spitaletta J. (September 2010). Radicalization: Relevant psychological and sociological concepts Ft. Meade, MD: U.S. Army Asymmetric Warfare Group, (10).
Dalgaard-Nielsen, Anja. (2010). "Violent Radicalization in Europe: What We Know and What We Do Not Know", *Studies in Conflict & Terrorism*, 33:9, (797-814).
Davies, L. (2008). "Educating Against Extremism: Towards a Critical Politicisation of Young People. International Review of Education", 55(2/3), (183-203).
Decision 46 adopted at the 197th session of UNESCO's Executive Board (197 EX/Decision 46) http:// unesdoc.unesco.org/images/0023/002351/235180e.pdf
Denoeux, Guilain & Carter Lynn. (2009). Development Assistance and Counter-Extremism: A Guide to Programming.
Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, (Draft), MAS, 2014, f. 32;42, aksesuar në
:https://arsimi.gov.al/wpcontent/uploads/2018/08/Strategji_APU_dokumenti_perfundimtar_24_03_2015.pdf
EU. (2017). *Key Competences-Curriculum Reform, Synthesis, Report, on Peer Learning Activities.* Belgium: EU Commission.
European Comission.(2019). *Key competencies for lifelong learning.* Louxembourg, 2019, aksesuar në: https://op.europa.eu/fr/publication-detail/-/publication/297a33c8-a1f3-11e9-9d01-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-107520914
***G**lobal Solutions Exchange, Recommendations on Donor Engagement with Civil Society on Preventing Violent Extremism* (2017)
Gtz & Bmz. (2008). *Learning to Live Together. Design, monitoring and evaluation of education for life skills, citizenship, peace and human rights*.(in collaboration ëith UNESCO)
Halsted, J. M., &Taylor, J. (1996). *Values in education and education in values*. London: Psychology Pres. (5)
Hamid, Mohsin, *Fundamentalist padashje.* Tiranë: Pegi.

Hedayah Center. (2016). *Guidelines and Good Practices: Developing National P/CVE Strategies and Action Plans*
Hedayah. (2013). *The Role of Education in Countering Violent Extremism.* http://www.hedayah.ae/pdf/role-of-education-in-countering-violent-extremismmeeting-
Holmer, G. (2013). *Countering violent extremism: A peacebuilding perspective*. United States Institute of Peace (USIP)
Hosseini, Khaled. (2007). *Gjuetari i balonave*, Tiranë: Omsca-1.
International Religious Freedom Report for 2018: *Report on International Religious Freedom: Albania. (2018).* United States Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor, https://www.state.gov/reports/2018-report-on-international-religious-freedom/albania/
Ismail Kadare. (2017). *Tri sprova mbi letërsinë botërore: Eskil, Dante, Shakespeare*. Tiranë: Onufri.
ISP. (2002). *Fjalor Edukimi (Psikologji-Sociologji-Pedagogji).* Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike.
IZHA. (2014). *Kurrikula e Arsimit parauniversitan i Republikës së Shqipërisë.* Tiranë: IZHA.
Kadare, Ismail. (2000). *Kronikë në gur*. Tiranë: Onufri.
Kadare, Ismail. (2015). *Gjenerali i Ushtrisë së vdekur*. Tiranë: Onufri.
Key Competences-Curriculum Reform, Synthesis, Report, on Peer Learning Activities. (2017). Belgium: EU Commission. EU
Leeuë, Jan De. (2018). *Babeli*. Tiranë: Dituria.
Ligji 69/2012, (2012). RSH, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë." Tiranë: Fletorja Zyrtare e Ligjeve të RSH
Ligji 56/2015 (datë 28.5.2015). "Për disa ndryshime në sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë." Tiranë: Fletorja Zyrtare e Ligjeve të RSH
Leëis, Bernard .(2009). *Islami dhe perendimi*. Tiranë: IDK
Macaj, Edlira. (2019). *Letërsi, ab initio*. Tiranë: Albas.
Manual trajnimi parandalimi i esktremizmit të dhunshëm",(2018). Projekti: "A Caravan for Social Challenges! A Caravan for your empoëerment" i zbatuar nga "Open Doors", 14-18 maj .
Mantovani, G. (1998). *L'elefante invisibile. Alla scoperta delle differenze culturali*, Giunti.
McCauley C. & Moskalenko, S. (2008) "Mechanisms of political radicalization: Pathëays toëard terrorism," *Terrorism and Political Violence* (416).
Meksi, Mira. (2016). *Pa zemër në kraharor*. Tiranë: Onufri.
Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS). (2014). *Korniza kurrikulare. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë.* Tiranë: MAS, (f. 9-10, 54).
Nathanaili, Valbona. (2018) *Rekomandimet e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe intolerancës në raportin e tij të tretë për Shqipërinë.* Këshilli i Evropës, 9 qershor 2015. https://www.valbonanathanaili.com/rekomandimet-e-komisionit-evropian-kunder-racizmit-dhe-intolerances-ne-raportin-e-tij-te-trete-per-shqiperine/
Ndërhyrjet për sjelljet pozitive në shkollë si mënyrë për parandalimin e dhunës, udhëzues për shkollat nënëtvjeçare. Aksesuar në: https://www.ascap.edu.al/nderhyrjet-per-sjelljet-pozitive-ne-shkolle/
New Perspectives on South-Eastern Europe, Civil Society and Transitions in the Western Balkans (2013)
OECD. (2008). *Trends Shaping Education. Centre for Educational Research and Innovation*.
OECD. (2009). *Education today: The OECD Perspective. Centre for Educational Research and Innovation, Education & Skills.*

OSCE and The Prevention Project, Civil Society Day – OSCE-ëide. (2017). *Counter-Terrorism Conference Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism*

***P**lani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së*, 2015.

RSH. (2012). Ligji 69/2012. *Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.* Tiranë.: Fletorja Zyrtare e Ligjeve të RSH.

Radikalizimi fetar dhe esktremizmi i dhunshëm në Shqipëri projektit "Parandalimi i radikalizmit fetar tek të rinjtë , IDM, Tiranë, 2015

Rychen, D. s. & Tiana, A. (2004). Developing Key Competencies in Education. Some Lessons Learned from International Experience. Geneva: UNESCO International Bureau of Education.

Said, E.W. (1978). *Orientalismo. L'immagine europea dell'Oriente (Orientalism*), Feltrinelli.

Saint Exupery, Antoine de.(2017). *Princi i Vogël.* Tiranë: Dituria.

Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit (Nëntor 2015)

***T**ë jetojmë së bashku, të ndërthurim diversitetin dhe lirinë në Evropën e shekullit 21: Raport i Grupit të Personave të Shquar të Këshillit të Evropës*, 2011, (5).

Toleranca fetare në Shqipëri,

Aksesuar në:

https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/religious%20tolerance%20albanian.pdf

Turning Point: A new comprehensive strategy for countering violent extremism. Centre for Strategic and International Studies (CSIS), (November 2016)

Ulqini, Kahreman. (2016). *Toleranca fetare e shqiptarëve në zigzaget e historisë.* Shkodër: Fiorentina, 2016, http://www.bibliotekashkoder.com/doc/TOLERANCA4.pdf

United Nations Development Programme (UNDP) and International Alert. (March 2018). *Improving the Impact of Preventing Violent Extremism Programming: A toolkit for Design, Monitoring and Evaluation*

United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization. (2016). *A Teacher's Guide on the Prevention of violent extremism*. Paris, France. http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002446/244676e.pdf

Yousafzai, Malala. *(2017). Unë jam Malala.* Tiranë: Pema.